



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 25 MAJ 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 25. MAJA 2016. GODINE**

**MAJ - MAJ
2016**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative,
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës,
6. Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2015,
7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit të Pavarur për Medie për vitin 2015,
8. Shqyrtimi i raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015,
9. Shqyrtimi i raportit të punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2015.

Dnevni red

1. Drugo razmatranje N/zakona br. 05/L-096 o sprečavanju pranja novca i borbi protiv terorizma,
2. Drugo razmatranje N/zakona br. 05/L-010 o Kosovskoj agenciji za upoređivanje i proveru imovine,
3. Drugo razmatranje N/zakona br. 05/L-067 o statusu i pravima paraplegičara i tetraplegičara ,
4. Drugo razmatranje N/zakona br. 05/L-031 o opštoj administrativnoj proceduri,
5. Razmatranje Predlog odluke Vlade Republike Kosova za imenovanje članova Komisije za zaštitu konkurencije,
6. Razmatranje izveštaja rada Agencije za menaždiranje memorijalnih kompleksa Kosova za 2015 godinu,
7. Razmatranje izveštaja Nezavisne komisije za medije za 2015 godinu,
8. Razmatranje izveštaja Institucije Narodnog advokata za 2015 godinu,
9. Razmatranje izveštaja rada Pravosudnog instituta Kosova.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra të Kabinet qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Në sallë janë të pranishëm 71 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

Adem Grabovci e ka kërkuar fjalën. Urdhëro!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!
Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, propozoj që pika pesë e rendit të ditës të shqytet për seancën e ardhshme. Kemi nevojë për konsultime të mëtutjeshme me Komisionin përkatës dhe në seancën e radhës mund ta futim në rend të ditës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi një propozim nga shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Na duhet vetëm votimi formal. Kush është kundër kësaj shtyrjeje? A ka kundër? 2 kundër. Abstenim? Një abstenim. Shtyhet për seancën e radhës.

Zenun Pajaziti e ka kërkuar fjalën. Urdhëro, zoti Pajaziti!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!
Unë e kam bërë një kërkesë edhe në emër të Komisionit, po ashtu edhe me kërkesë edhe të Qeverisë që në rend të dite të hyjë plotësim-ndryshim i Ligjit që ka të bëjë me regjistrimin e popullsisë dhe ekonomive familjare dhe banesave në komunat serbe, që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011.

Më lejoni ta lexoj këtë kërkesë, e pastaj ta jap një sqarim të shkurtër.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie propozon që shqyrtimi i Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave në komunat e Kosovës që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, në bazë të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit, të bëhet me procedurë të përsheptuar - shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 56, paragrafi 1 dhe neni 57, paragrafët 3, 8 dhe 9 të Rregullores së Kuvendit dhe atë si vijon:

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave në komunat e Kosovës që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011 të bëhet në seancën plenare më 25 maj 2016.

Shqyrtimi i Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave në komunat e Kosovës që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011 nga

Komisioni Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie dhe komisionet e përhershme duhet të përfundojë jo më vonë se më 31 maj 2016.

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave në komunat e Kosovës që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011 të bëhet në seancën plenare jo më vonë se më 2 qershor të vitit 2016.

Më lejoni ta jap po ashtu sqarimin shtesë se Qeveria e ka proceduar në Kuvend Draftligjin për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave në katër komunat e Kosovës në të cilat nuk është zhvilluar ky proces në vitin 2011 dhe të cilat nuk kishin marrë pjesë në kohën e rregullt të mbajtjes së tyre për shkaqe të njohura politike.

Unë e kam marrë po ashtu një kërkesë nga ministrja e Dialogut, zonja Tahiri, e cila e ka arsyetuar rëndësinë e këtij projektligji dhe mundësinë që kjo të bëhet më shpejt dhe po ashtu nga Zyra e BE-së në Kosovë, e cila ka planifikuar një mbështetje të veçantë për realizimin e këtij projektligji gjatë kësaj periudhe të këtij viti.

Prandaj, është kërkuar që tani është koha ideale që kjo do të mund të bëhej.

Dhe, siç e dimë, miratimi i këtij ligji mundëson realizimin e regjistrimit të popullsisë edhe në këto komuna për të cilat ne i dimë arsyet që nuk janë zhvilluar dhe kjo është periudha ideale, për të mos thënë ndoshta e fundit, që mund të përputhen shënimet nga regjistrimi i dalë. Prandaj, edhe kërkohet që kjo të bëhet në vjeshtën e këtij viti. Por, nëse ky projektligj nuk realizohet tash, nuk do të ketë kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur edhe teknikisht, edhe administrativisht, që të realizohet ky aktivitet i rëndësishëm i regjistrimit të popullsisë për periudhën e paraparë dhe po ashtu nëse vonohemi ne nuk do të kemi as mbështetje të mjaftueshme nga jashtë në periudhën tjetër vijuese.

Prandaj, të nderuar deputetë,

Unë kërkoj që të hyjë në rend të dite kjo pikë dhe të procedojmë me këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar zoti Pajaziti!

Tani kërkohet deklarimi i grupeve parlamentare për këtë propozim për plotësimin e rendit të ditës të seancës plenare.

Nga PDK-ja dhe LDK-ja nuk ka reagim. Jeni për? Nga "Vetëvendosja", a ka reagim? Shkojmë një herë me grupet parlamentare. Zonja Tërmkolli, në emër të grupit apo tuajin? Ok-ej!

Atëherë Lëvizja "Vetëvendosje" nuk është. Grupi Parlamentar AAK nuk është. Nga Grupi Parlamentar Lista serbe nuk është lajmëruar askush. "Nisma" nuk është. "6+" nuk ka. E kemi vetëm një deputet të lajmëruar, zonjën Tërmkolli. Urdhëroni, fjala për ju!

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Mua më vjen keq, nuk e di nëse Grupi Parlamentar i LDK-së e ka diskutuar këtë çështje apo jo, nëse ka marrë vendim apo jo, por unë dua ta shpreh mendimin tim për këtë çështje.

Dhe që në fillim dua të them që jam kundër procedimit të këtij ligji në Parlamentin e Kosovës. Kosova ka ligj për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe banesave. E ka ligjin! E ka bërë regjistrimin në vitin 2011. Ai ligj nuk është shfuqizuar. Ligji është në fuqi.

Një ligj i ri në Kosovë për regjistrim të një pjese të popullatës, në fakt, është ligj për regjistrim në një shtet tjetër. Nëse për ju ato katër komuna janë shtet tjetër, për mua ato janë Kosovë. Ato janë Kosovë! Dhe, nëse janë Kosovë, ligji ekziston. Unë e kam parë me vëmendje këtë ligj, e fakti që duhet nxjerrë ligj të ri për të njëjtën çështje, për të cilën ekziston ligji, për qytetarët brenda territorit të Kosovës, më falni ju lutem, nuk e di çfarë jeni duke bërë. Unë nuk e di çka jeni duke bërë!

A ka kërkuar Bashkimi Evropian, a ka kërkuar Zyra e zotit Zhbogarit, silleni Zhbogarin këtu dhe diskutojmë dhe e shohim! Sa ligje i bënë Sllovenia? Sa ligje i bëjnë të tjerët për regjistrim të popullsisë? Më falni, unë jam për regjistrimin e popullsisë, mirëpo me ligjin ekzistues. Ne e dimë që për shkak rrethanave specifike qytetarët në atë pjesë të Kosovës nuk janë regjistruar për shkak të atyre rrethanave dhe ne e kemi pranuar shtyrjen për një kohë të caktuar të regjistrimit. Pra, jemi për regjistrim nga Agjencia e Statistikave të Kosovës me ligjin ekzistues, me Zyrën për Regjistrim dhe, natyrisht, shiheni: po parashihet një komision tjetër shtetëror për regjistrim. Po ju, lutem mos bëni hajgare më, nuk janë këto punë për hajgare, janë punë shumë serioze. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Tërmkolli! Ismeti e ka kërkuar fjalën, shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ndërkohë edhe Zenun Pajaziti në të njëjtën kohë.

Urdhëro, zoti Beqiri!

ISMET BEQIRI: Një projektligj që ka ardhur nga Qeveria unë besoj që është analizuar mirë. Sidoqoftë, nuk e shoh shumë problem që kjo punë për një javë ditë të shtyhet, le të vijmë ta arsyetojmë. Këtu nuk është askush prej Qeverisë që ta arsyetojë këtë projektligj dhe me gjithë rëndësinë, unë nuk e besoj që një javë ditë na prish punë, ta këqyrim këtë punë, t'i heqim dilemat, sepse as nuk dëshiroj të besoj dhe as nuk e besoj që na vjen një ligj i cili bën regjistrim në kuptimin e asaj që një regjistrim vlen për një shtet, e tash, siç e tha kolegja ime shumë e nderuar, Melihatja.

Sa i përket kësaj çështjeje, po e them edhe një herë, nuk kemi asnjë arsye ta bëjmë problematike për një javë, materiali është, ka deputetë që s'e kanë prekur fare me dorë ta këqyrin e ta analizojnë. Le ta analizojnë dhe vijmë javën tjetër dhe mund ta përkrahim, dhe vjen dikush prej Qeverisë që ta arsyetojë pse duhet të futet në rend të ditës. Kaq! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Pajaziti e ka fjalën, le të përgatitet zonja Musliu.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Një arsye, një kërkesë që u bë për t'u shtyrë për një javë ditë, ndoshta argumenti kryesor është që është këtu një ministër i Qeverisë që ta arsyetojë.

Përndryshe, një kërkesë e tillë për një projektligj që e trajton një çështje të ndjeshme, siç është regjistrimi i popullsisë, do të ishte mirë të kishte qenë e koordinuar më mirë ndërmjet të atyre që e propozojnë projektligjin dhe grupeve parlamentare të partive politike që e përbëjnë koalicionin.

Për më tepër, unë nuk dëshiroj të arsyetohem tash këtu për ato që zonja Tërmkolli i shtroi, se nuk e di, jemi mësuar tani disa muaj në këtë Kuvend t'i trajtojmë njëjtë nga aspekti "patriotik" të gjitha çështjet, gjë që nuk është mirë.

Ky projektligj ka të bëjë me një proces, i cili do të realizohet nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe është fjala për ta përmbyllur një proces që ka mbetur gjysmë dhe është mirë të përmbyllet. Se a bëhet me një projektligj të ri, apo me plotësim-ndryshimet e projektligjit ekzistues, këtë megjithatë ekspertët e Qeverisë e kanë konstatuar. Është mirë që edhe ekspertët juridikë të Zyrës Ligjore të Kuvendit ta trajtojnë nëse ka kohë për këtë punë.

Por, dëshiroj të kërkoj që të mos apostrofohen zyrat ndërkombëtare. Unë e përmenda Zyrën e BE-së vetëm që ka planifikuar resurse për ta mbështetur këtë aktivitet për këtë vit, e nuk thashë që është ndonjë kërkesë eksplicite e tyre për diçka tjetër. Kjo është për aq sa unë di. Por, përndryshe, dëshiroj të mos i jepen këto epitete këtij projektligji, sepse është një proces i rëndësishëm që duhet përfunduar, pavarësisht nëse pajtohen grupet politike a etnike në Kosovë për këtë çështje.

Procesi i regjistrimit të popullsisë më së voni duhet të kryhet tash në këtë vit dhe kjo është në të mirë të planifikimit të zhvillimit ekonomik të vendit dhe proceseve tjera që po ndodhin në këtë vend. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Musliu e ka fjalën, ndërkohë Shpejtim Bulliqi, Melihate Tërmkolli prapë e ka kërkuar fjalën dhe zoti Slavko Simiq. Urdhëro, zonja Musliu!

GANIMETE MUSLIU: Kryetar, ka replikë së pari, apo unë po e marr fjalën?

KRYETARI: Replikë, zonja Tërmkolli! Në qoftë se jeni për replikë, urdhëro menjëherë.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Zoti Pajaziti unë kam respekt shumë të madh për secilin deputet këtu, natyrisht edhe për ju, dhe nëse duhet ta trajtojmë nga aspekti patriotik apo jo, unë mendoj që me të vërtetë duhet t'i trajtojmë të gjitha çështjet nga aspekti patriotik.

Por, nëse ju mendoni për njëfarë primitivizmi, atëherë primitivizmin po ia lë tjetërkujt, por duhet ta trajtojmë në aspektin patriotik profesional. Unë mendoj që kjo nuk është çështje primitive, por është çështje profesionale, sepse merreni çdo kund në botë dhe trajtojeni këtë çështje, nëse nuk gjeni këso mënyra, atëherë më tregoni edhe mua. Unë po them edhe një herë: jam për regjistrim gjithsesi për arsye të specifikave që i ka aktualisht Kosova, por për regjistrim me ligjin ekzistues,

sepse ai ligj është i mjaftueshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës, nëse ato katër komuna ju i konsideroni pjesë të Kosovës, e unë i konsideroj pjesë të Kosovës.

Sa u përket zyrave, mos u bëj shumë merak, përgjegjësinë çfarë them unë e marr vetë.

KRYETARI: Faleminderit! Zenuni ndërkohë, reagim? Por, vendimin do ta merrni në fund vetë. Urdhëro, Zenun!

ZENUN PAJAZITI: E para, nuk besoj që jam përfshirë ndonjëherë në ndonjë replikë me një fjalor që përmendet primitivizmi, dhe s'e përmenda as sot këtu. Mendoj që zonja deputete e sqaroi vetë këtë çështje.

Unë thashë dhe po e them që nuk duhet t'i japim dimension tjetër këtij aktiviteti. Bëhet fjalë për një ligj tonin të Republikës së Kosovës që ka për t'u realizuar me ligjet, me njerëzit, me krejt potencialet e Republikës së Kosovës dhe s'ka të bëjë kurrgjë me çështje të tilla. Dhe, nëse do ta sqarosh patriotizmin, patriotizëm është që t'i lexosh dokumentet, t'i koordinosh me grupet parlamentare, me Qeverinë, të bëhen aktivitete në këtë vend sa më mirë që mundemi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, zonja Musliu e ka fjalën. Përgatitet deputeti zotëri Shpejtim Bulliqi, Slavko pastaj.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Fillimisht mendoj që ky shqetësim që e shtroi zonja Tërmkolli nuk duhet të merret si tendencë ose si refuzim i një ligji, por megjithatë unë konsideroj që Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të marrë mësim nga ky rast dhe asnjëherë të mos na servojë dokumentacione, ligje ose projektligje, të cilat nuk ka vetë gatishmëri dhe vullnet që të vijë dhe t'i mbrojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kërkoj nga shefat e grupeve parlamentare dhe nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës që ligjet ose projektligjet që vijnë në Kuvend dhe për të cilat nuk i kemi ministrat ose anëtarët e Kabinetit qeveritar, të cilët janë përgjegjës për të dhënë sqarime dhe për t'i mbrojtur dokumentet, të cilat i sjellin para nesh, të mos futim fare në rend ditës dhe të mos na krijojnë situata të tilla.

Gjithashtu, e kam edhe një vërejtje të vogël ndoshta, ose pak ndoshta edhe me humor dua t'ia them edhe Ismet Beqirit, se nuk është mirë gjithmonë të nisemi prej vetit, sepse nuk del gjithmonë mirë, edhe pse thuhet "nëse dëshiron të bësh mirë, nisu gjithmonë prej vetes", por kjo nuk qëndron se nuk del gjithmonë ashtu. Nëse ju nuk i lexoni ligjet, besoj që nuk ka të drejtë të thuhet që ka deputetë të cilët nuk i lexojnë ligjet, sepse vetë fakti që ne kemi hapur diskutim dhe jemi të gatshëm për të diskutuar dhe për të debatuar për këto pika të rendit të ditës, konsideroj që jemi shumë në rregull. Por, nëse ju nuk i lexoni është mirë të thuhet që unë s'e kam lexuar Melihate dhe prandaj po të jap të drejtë, por jo t'i akuzosh deputetët, sepse është bërë një praktikë shumë e keqe që të ofendohen deputetët.

Kështu që, ose po punojmë, ose po e lëmë këtë punë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri, doni replikë?

ISMET BEQIRI: Nuk po e them në kuptim të replikës për Gonën deputete, por singërisht po e them sot nuk është kërkesë e Qeverisë që të futet në rend të ditës, e para, nga asnjë ministër.

E dyta, kur e thashë atë, nuk e thashë me keqdashje nëse mund të thuhet ndaj ndonjë deputeti, por edhe një herë po e them - vetë fakti që s'e kemi diskutuar edhe në grup, unë ju siguroj që ka deputet që s'e ka lexuar, që s'e ka marrë as si material dhe këtë nuk e them në bllok për të gjithë, por këtë që e thashë e them me përgjegjësi të plotë, sepse do ta bisedonim edhe në grup dhe kjo është e vërtetë. Ka deputetë që s'ka arritur ta lexojë, jo që s'ka dashur, dhe besoj që këtu nuk e kemi ndonjë keqkuptim për këtë. Edhe një herë po e përsëris: për t'u ikur të gjitha këtyre keqkuptimeve e bëjmë këtë punë - e shtyjmë për një javë dhe e rregullojmë. Nuk është më ndonjë urgjencë edhe një herë po e përsëris.

KRYESUESI: Faleminderit! Ganimetja e ka fjalën se ka kundër-replikë, një minutë.

GANIMETE MUSLIU: Edhe unë e thashë me shumë dashamirësi zoti Beqiri dhe pa hidhërim, por megjithatë konsideroj që nuk ka nevojë Parlamenti dhe deputetët të bëhen tabelë qitjeje qysh ka ndodhur këto ditët e fundit, të mos them këto vitet e fundit.

Ka ardhur momenti i fundit që përgjegjësia të bjerë edhe mbi individin, e jo mbi kolektivin. Nëse ka deputetë të papërgjegjshëm të thuhet: "Ganimete Musliu është e papërgjegjshme", por jo të përfshihen të gjithë deputetët në paketë, sepse është bërë praktikë e keqe, e cila më së shumti e dëmton Republikën e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Ne e dëgjuam edhe propozimin, kërkesën e komisionit, që ishte e arsyeshme dhe ne e kuptojmë rëndësinë e këtij ligji në mënyrë absolute, por edhe kërkesat e deputetëve duhet t'i kuptojmë, sepse regjistrimi i popullsisë është tepër i rëndësishëm. U paraqitën këtu shqetësime dhe unë mendoj që duhet t'i japim fund një praktike të krijimit të privilegjeve për grupet e caktuara, apo për pjesë të caktuara.

Kosova është një dhe e pandashme dhe ligjet e Kosovës duhet të shërbejnë në gjithë territorin e Kosovës dhe karshi kësaj, unë mendoj edhe një arsytim tjetër që e kanë deputetët, nuk e kanë marrë materialin. Ky ligj mund të presë për lexim të parë edhe një javë kur të jenë e pranishme edhe Qeveria dhe nëse deputetët kanë kërkesa shtesë nevojë për sqarime, Qeveria është kompetente që do t'ua japë ato dhe unë pajtohem që në emër të grupit parlamentar, pas konsultimeve që i pata, të shtyhet për një javë shqyrtimi i këtij ligji.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bulliqi e ka fjalën.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, kryesues!

Përschëndetje të respektuar deputetë,

Qytetarë të respektuar,

Unë desha t'i them nja tri fjalë rreth çështjes së këtij projektligji dhe propozimit të kolegut rreth këtij projektligji.

Në radhë të parë mendoj që është për t'u përschëndetur gatishmëria e komunitetit serb që faktikisht në këtë fazë të përfshihet në suaza të regjistrimit për arsye se e dimë që në regjistrimin e vitit 2011 faktikisht nuk i janë përgjigjur, ose i është përgjigjur një numër relativisht i vogël i këtij komuniteti. E dyta, është mirë që për këtë projektligj, meqë ka qenë me kaq urgjencë të jetë këtu ministria përkatëse, si sponsorizuese e këtij projektligji, dhe besoj që më mirë do të ishte të kishte ardhur këtu dhe t'i kryente detyrat e veta, e të mos merret me politika ditore, por ministria t'i kryejë punët edhe obligimet e veta që i takojnë me ligj. Dhe, e treta që desha ta them dhe të përkujtoj që në baza hartografike e këtij regjistrimi është e gatshme dhe mendoj që është njëra prej bazave hartografike më të mira, jo vetëm në Ballkan, por ndoshta edhe në Evropë, dhe pak shtete deri sot kanë arritur ta realizojnë një bazë të tillë hartografike për regjistrimin e popullsisë.

Dhe, meqë është gatishmëria e këtij komuniteti, shpresoj që ky proces mund të kryhet shumë shpejt edhe mund t'i ketë rezultatet e kërkuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Për të mos e komplikuar tani çështje përgjegjësisë, unë e kam shkresën e kryeministrit, në të cilën thotë që "kryeministri do ta prezantojë projektligjin në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës në të cilën do të shqyrtohet ky projektligj". Në rast të mungesës së kryeministrit, projektligjin do ta prezantojë njëri nga zëvendëskryeministrat, ose një ministër tjetër, të cilin e ka caktuar kryeministri.

Asnjëra s'ka ndodhur, kështu që kërkesa për ta shtyrë për javën tjetër mendoj që është e arsyeshme, sidoqoftë para se ta hedhim në votim formal, ia jap fjalën zotit Simiq që ta thotë mendimin e vet, ose të grupit. Faleminderit!

SALVKO SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

Poštovani ministri,

Poštovane dame i gospodo,

Narodni poslanici,

Zbog veoma važnog i bitnog procesa kada je u pitanju sprovođenje popisa stanovništva na severu Kosova, mislim da je zaista neophodno da neko iz Vladinog kabineta bude prisutan ovde i da nam obrazloži Nacrt zakona i poslanička grupa Srpske liste predlaže i podržava g. Ismeta Beqirija i g. Adema Grabovcija da se ova tačka dnevnog reda odloži i da se ona uvrsti na Predsedništvo, i da ona kao redovna tačka dnevnog reda dođe na sledećoj sednici. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, qëndrimi i të gjithëve është njësoj. E bëjmë një votim formal për të mos e futur në rend të ditës.

Votojmë pra formalisht. Atëherë e shtyjmë për javën e ardhshme, sipas procedurave përkatëse.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit

Komisionet parlamentare, në pajtim me vendimin e Kuvendit të datës 18 maj 2016 e kanë shqyrtuar Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funksional, zotin Naser Osmani, që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin me rekomandimin. Zoti Osmani, e keni fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Komisioni e ka shqyrtuar dhe e ka amendamentuar projektligjin në një periudhë të përshpejtuar, në një procedurë të përshpejtuar.

Në ndërkohë i kemi pranuar komentet nga zyra e Bashkimit Evropian dhe EULEX-it, si dhe nga organizatat e shoqërisë civile, që kanë shprehur vërejtjet dhe shqetësimet për përmbajtjen e projektligjit. Në takimet e zhvilluara me ekspertë të Zyrës së BE-së është thënë projektligji përgjithësisht nuk është në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian. Ka disa dispozita që mungojnë dhe disa të tjera që nuk janë në harmoni me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ata i kanë paraqitur vërejtjet në dispozitat konkrete.

Për shkak të kohës së kufizuar të procedimit të këtij projektligji për komisionin ka qenë e pamundur të rregullohen të gjitha këto çështje që prekin shumë nene, duke e kuptuar natyrën urgjente të miratimit të këtij ligji që ka të bëjë me anëtarësimin e njësisë së inteligjencës financiare në shoqatën EGMOND në të njëjtën kohë i rekomandojmë Ministrisë së Financave që menjëherë pas kësaj ta rishikojë ligjin në bashkëpunim me ekspertët, përfshirë edhe ata të Bashkimit Evropian, për ta vlerësuar përputhshmërinë e këtij ligji me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe të propozohen ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme që në një mënyrë Raporti i Progresit për këtë çështje të mos jetë negativ.

Për këtë Qeveria, respektivisht Ministria e Financave, pasi të kalojë kjo, që rekomandojmë të votohet kështu siç është, duhet të fillojë menjëherë amendamentimin dhe të jetë e përfunduar deri në tetor, përndryshe në për këtë çështje do të marrim vlerësimin negativ nga BE-ja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim. Projektligji ka 37 amendamente nga Komisioni Funksional. Fjalën e ka zoti Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë dola të sqaroj dhe të nënvizoj disa çështje që lidhen edhe me këtë ligj edhe me praktikën e ligjeve që vijnë ngutshëm në Kuvend dhe pastaj del që hapat e ngutshëm nuk janë edhe të sigurt.

Në e patëm bisedën para kësaj rreth rendit të ditës, që u propozua një ligj të bëhet me procedura shumë të ngutshme dhe pastaj u bë një diskutim që mua nuk më pëlqeu, sepse bëhej njëfarë diskutimi si të gjuhej topi “jo Qeveria, jo Kuvendi”. As Qeveria, as Kuvendi, as Kryesia, as kryetarët e grupeve parlamentare nuk kanë kërkuar që ai ligj të lexohet ngutshëm. Mirë, është Kuvendi që propozon dhe atëherë problemi nuk duhet të referohet te ata që s’e kanë pasur në

rend dite hiç. U vendos siç u vendos, por unë po kthehem tash te ky të cilin e kërkuam në mbledhjen e kaluar, kërkuam të kalohet me marrëveshje të Kuvendit - lexim i shpejtë, u fiksuan të dyja leximet. Çfarë ndodhi? Thanë që është ligj i rëndësishëm, u përcaktua edhe data deri kur duhet të bëhet leximi i dytë, bile edhe data deri kur duhet të hyjë në fuqi. Pse? Sepse, qenka i domosdoshëm, qenka koha e fundit që të valorizohet edhe ky ligj edhe për nevojat legjislative të Kosovës karshi obligimeve ndërkombëtare, kombëtare, e tjera...

Problemi është i leximit të shpejtë edhe në komisione dhe i vlerësimit të kryetarit të Komisionit Funkcional, Naser Osmani, që u përpoqa shpejt t'i regjistroj dy vlerësimet e tij, të cilat janë të sakta, unë them, për ligjin dhe për procedurën, por dhe shumë kontradiktore rreth çështjes së ligjit, kalimit të tij, nevojës së tij. Pse? Raporti i Komisionit Funkcional thotë që të gjitha komisionet e përhershme faktikisht në një tip të kulluar të "pa halë e pa pikë", si thonë, e pranojnë ligjin, ndërsa në diskutimet parlamentare individuale secili bën vërejtje. Po, në germë të shkruar e kemi që Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian, thotë komisioni.

Naser Osmani, si shef i komisionit që mbledh këto tash, thotë që Komisioni Evropian, ose përfaqësuesit e BE-së, më shkurt, thonë që ky ligj nuk është në pajtim me direktivat. Unë vetëm po lexoj dhe po i interpretoj dy qëndrime. Pra, komisioni thotë është në rregull.

Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar që projektligji me amendamentet është në pajtim me Kushtetutën, ligjet e rregulloret e tjera dhe ka rekomanduar... Shikoni, Komisioni për Legjislacion çfarë ka rekomanduar, që në një pikë atje... 3.3, neni 56, në vend të fjalës "mund" të zëvendësohet "duhet". Pikë! Kjo është. Domethënë ligji nuk është perfekt, por në kufi të perfekte a të përkryerës, që do të thotë të kryer. Edhe për komunitetet po ashtu, thotë: "... ky ligj nuk i nguc komunitetet", pra ne kemi në germë moskontestimin e asgjëje dhe kemi në vepër, që ligji s'është i mirë, që Komisioni Funkcional ka pasur probleme rreth këtyre, që ato zyrat e famshme që po i quani ju zyra, unë s'di... ato duhet edhe të kenë adresë, edhe ajo zyra e bashkësisë lokale ka adresë, se lëre më zyra universale nëse janë. Atëherë le të dihet, sepse këtu po vijnë nëpërmjet korrierëve të nivelit të shtatë a të tetë mendimet. Njëri thotë "BE-ja thotë që është në rregull", tjetri thotë "jo, BE-ja thotë që s'është në rregull", po kurrë nuk del individi kush është ai që po thotë.

Dhe, tani ne e kemi një raport gojor të zotit Osmani në emër të komisionit, që nuk thotë se çka thonë raportet e shkruara të komisioneve dhe, e dyta, Osmani si njeri që e njeh veprimtarinë thotë: "Ligji s'është i mirë. Po na thonë votojeni, ne do ta votonim...", veçse e thërret ministrinë e resorit, që menjëherë që kur të votohet t'i rihyjë, thotë Osmani, përmirësimit të ligjit, sepse është e garantuar që BE-ja thotë, do ta vlerësojë si ligj të keq. Do ta bëjnë negativ Raportin e Progresit në kuptimin e legjislacionit, pra ne jemi këtu.

Unë me qëllim e përmenda edhe Osmanin, edhe të tjerët, nëse nuk e interpretova qartë, unë ju thërras të më ndihmoni ta interpretoj qartë.

Dhe, e fundit, kur është diskutuar tjetrën herë ky ligj, unë e kam drejtuar seancën, është një kolege këtu që atëherë më bëri vërejtje se përse po ngutem dhe unë atëherë i kam thënë dhe sot

po them - jam ngutur ta detyroj ministrin e resorit që të flasë para Kuvendit, të mos shqyrtojmë ligj të paqenë dhe sot që jemi te leximi i dytë, unë propozoj që të mos bëhet leximi i dytë pa qenë përgjegjësit dirkt të sponsorizimit të ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Osmani ka kërkuar fjalën, sërish.

NASER OSMANI: Kryesues!

Unë u mundova të jem korrekt me deputetë dhe të paraqes krejt ato sfida, ato probleme që ne si komision i kemi pasur, që nganjëherë po biem në situatë shumë delikate, por nganjëherë po biem në situata që më s'po jemi as deputetë.

Unë propozimin në fund e dhashë, rekomandimi i komisionit është që të votohet kështu si është. Që ministri apo s'që ministri, ne sot duhet ta votojmë këtë draft në leximin e dytë kështu si është dhe kam thënë qartë, pasi që kjo të kalojë, se duhet të jetë në fuqi deri më 7 qershor për t'i arritur afatet kohore, që Kosova të bëhet pjesë e Asociacionit të EGMOND, ajo është një shoqatë. Dhe, pasi që të arrihet kjo, që Qeveria pastaj të fillojë që në bashkëpunim me ekspertët e ndryshëm edhe të BE-së edhe të EULEX-it dhe të Qeverisë të formojë grupin punues për ta përmirësuar e draftuar ligjin për të qenë kompatibil me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Kështu e kam thënë, prandaj unë propozoj që ligji të votohet.

KRYESUESI: Faleminderit! A ka dikush tjetër për të diskutuar? Jo! Nuk është paraqitur askush që të diskutojë lidhur me çështjet e ngritura. Mua më mbetet të vazhdoj me votimin e amendamenteve, edhe pse mendoj që këto që i tha më parë zoti Hamiti janë çështje shumë serioze, me të cilat do të ishte dashur që të merrej Qeveria, të merreshin edhe komisionet, të takoheshin edhe bashkë dhe t'i shqyrtonin për t'i bashkërenditur çështjet, të cilat nuk janë në harmoni me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Meqenëse është kështu, unë po vazhdoj me votimin e juaj.

Pra, po votojmë 37 amendamentet e Komisionit Funkcional. Sa deputetë janë në sallë, ju lutem? Në sallë janë 68 deputetë.

Amendamenti 1

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 14.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 16.

Zonja Alma e ka kërkuar fjalën për amendamentin e 16-të.

ALMA LAMA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Unë kam një kërkesë për sqarim, në fakt, sepse është bërë një ndryshim në këtë paragraf, ku kërkohet që të fshihet emri i ligjit, ku bëhet identifikimi i subjekteve politike dhe kërkoj sqarim se përse është bërë kjo, sepse më duket shumë më e saktë në ligj, që dëshmitë e të qenit i regjistruar si parti politike të jenë në pajtim me Ligjin për subjektet politike në Kosovë. Duke qenë se ligji po kalon shumë shpejt, nuk kemi marrë arsyetime për këto amendamente. Mendoj se duhet të sqarohet, se përse është bërë ky ndryshim, nëse ka mundësi?!

KRYESEUSI: Zoti Osmani, e keni fjalën.

NASER OSMANI: E kemi pasur parasysh, kryetar, edhe këtë që e thotë, por ne në Kosovë ende nuk e kemi Ligjin për subjektet politike dhe derisa nuk bëhet Ligji për subjektet politike, duhet të jetë legjislacioni në fuqi.

KRYESUESI: Vazhdojmë!

Amendamenti 16

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 19.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 22.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 32

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 33

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 34

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 35

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 36

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 37

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe juve, të nderuar deputetë dhe zonja deputete, të përgatiteni për votim! Votojmë tani! Faleminderit!

Konstatohet se me 58 vota për, 7 abstenime dhe asnjë kundër, Kuvendi e miratoi Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahësim të Pronës dhe Kuvendi i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj raportuesen e Komisionit Funksional për Legjislacion, zonjën Selvije Halimi që të paraqet dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Zonja Halimi, e keni fjalën!

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar anëtarë të kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, duke u bazuar në nenin 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me 10.5.2016 shqyrtoi Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës me amendamentet e propozuara nga komisioni dhe vendosi që Kuvendi t'i paraqet raportin me amendamente.

Nënkryetar, ju lutem, gjatë votimit të amendamenteve e kemi një lëshim teknik të amendamenti 2, kështu që kur të vijen radha e votimit të amendamenti 2 kërkoj që t'ua jepni fjalën në mënyrë që ta bëjmë atë korrigjim. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Zhivković e ka fjalën.

JASMINA ZHIVKOVIĆ: Zahvaljujem se predsedavajući za datu reči, i zamoliću kolege za malo pažnje vezano za ovaj nacrt zakona s obzirom da se ovaj nacrt zakona zapravo drugo razmatranje ovog nacrta zakona o Kosovskoj agenciji za upoređivanje i proveru imovine nalazi na drugom čitanju i nalazi se bez izveštaja stalne komisije - Komisije za zaštitu prava i interese zajednica i povrata.

Po članu 56. Poslovnika, ovaj zakon je u prvom čitanju na Skupštini usvojen 7. Aprila 2015. Godine, i ovaj se zakon u Komisiji za zakonodavstvo, kao funkcionalna komisija, nalazi znači već godinu dana, što znači da je po članu 56. Poslovnika već prekršeno i prošli su svi rokovi za razmatranje ovog nacrta zakona.

S obzirom da se preko više od 95% sadržaja ovog zakona odnosi na zaštitu prava i interese zajednica, pre svega osnovno ljudskog prava odnosno imovine koje se tiče zajednica, a da se na drugom čitanju nalazi bez izveštaja stalne komisije za zaštitu prava i interese zajednica a kao razlog za to se navodi da Komisija nije ispoštovala 10 dana koje su predviđene po Poslovniku da se razmatra ovaj nacrt zakona, ostaje mogućnost za tumačenje duplog standarda i duplo tumačenje Poslovnika po kojima se sve funkcionalne i stalne komisije imaju obaveze za razmatranje ovog zakona.

Zbog velike važnosti ovog zakona, moj bi predlog bio da se danas ne glasa za drugo razmatranje ovog nacrta zakona i da se dozvoli i Komisiji za zaštitu prava i interese zajednica kao i Komisiji za zakonodavstvo da može razmatrati ovaj zakon u komisiji i dati pismeni izveštaj. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Zonja Halimi, urdhëro!

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Është e vërtetë ai shqetësimi që e ngriti kolegia, që ky projektligj tashmë ka një vit që është në Kuvend. Ne kemi pasur informacione që komisioni për komunitete gjegjësisht komuniteti nga ana e serbëve janë duke e shqyrtuar këtë projektligj dhe kemi pasur informacione por jo zyrtarisht se janë duke diskutuar rreth këtij projektligji.

Ne kemi pritur një kohë të gjatë se a do të drejtohen këta me ndonjë shkresë zyrtare apo ndonjë shqetësim. Këta nuk janë drejtuar me shkresa zyrtare për asnjë çështje. Ne jemi detyruar që të përfundojmë procedimin e këtij projektligji dhe kemi shkuar në lexim të dytë që do të thotë se e kemi raportin me amendamente për sot në seancë.

Para një muaji ne kemi përfunduar punën dhe sipas Rregullores së Kuvendit komisionet tjera të përhershme kanë një afat njëmuajor që të shqyrtojnë raportet me amendamente të komisioneve funksioneve dhe ky afat ka kaluar.

Realisht, nëse pyetemi në formën më reale apo në mundësinë më të mirë të mundshme, ndoshta edhe ne përgjithësisht nuk do të ishim të kënaqur me përmbajtjen e këtij projektligji, por me qëllimin më të mirë që të gjithë në Kosovë të ndihen më mirë, të gjithëve në Kosovë tu zgjidhet problemi apo e drejta e pronës, ne kemi shkuar me leximin e dytë të këtij projektligji dhe sot është në seancë.

Nuk kemi arsye pse është vonuar nga Komisioni për Komunitete. Nuk kemi pasur as reagime nga anëtarja e komunitetit serb në Komisionin për Legjislacion. Ai është përmbajtur nga votimi por s'kemi pasur reagime të shprehura se për çka kanë ata pakënaqësi rreth këtij projektligji.

Sido që të jetë ne jemi në fazën kur mund të bëjmë leximin e dytë apo votimin e amendamenteve, ose edhe të shkojmë në leximin e tretë, por nuk po kemi arsye reale se pse janë të pakënaqur apo pse Komisioni për komunitete nuk e ka bërë shqyrtimin e raportit me amendamente nga Komisionit Funksional, në këtë rast të legjislacionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Zhivković, replikë!

JASMINA ZHIVKOVIĆ: Zahvaljujem se predsedavajući!

Vrlo ozbiljno shvatajući važnost ovog zakona i vrlo ozbiljno shvatajući potrebe kako svi građana koji živena Kosovu tako i pre svega zajednice koje žive na Kosovu, baš zbog toga reagujemo na ovaj Nacrt zakona.

Komisija za zaštitu prava i interese zajednice je godinu dana čekala na izveštaj funkcionalne komisije i ako je Komisija za zajednice godinu dana čegala na izveštaj funkcionalne komisije, a što po poslovniku Skupštine jeste rok 3 meseca, smatram da opravdanje da Komisija za zajednice nije ispoštovala rok od 10 dana i dala svoj pismeni izveštaj a opet se radi o vrlo važnom pitanju koje se tiče svih građana Kosova, pre svega zajednica, mislim da nije opravdan da se ovaj zakon danas nađe na drugom čitanju. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Milena Milicević e ka fjalën!

MILENA MILIČEVIĆ: Hvala predsedavajući! Ja tačno je da sam bila uzdržana na samoj Komisiji, ali sam za to bila član radne grupe godinu dana i radilasam na nacrtu ovog zakona.

Na toj radnoj grupi ja sam se trudila i usmene iznosila sve što se tiče ovog zakona a što nije ispoštovano u Briselskom sporazumu dovela sam i stručnjake koji su zaduženi za imovinu i koji su detaljno obrazlagali zbog čega ovaj zakon nije u interesu nevećinskih zajednica.

Amandmane sam usmeno iznosila. Nisam ih iznosila pismeno tako sam dobila i obrazloženje da mogu usmeno da se obračam na radnoj grupi od gospodina Zemaj, tako da i tačno je da sam na samoj komisiji bila uzdržana jer su tog dana bili amandmani u paketu i ja nisam htela da glasam za amandmane jer nije bilo svrhe nijedan amandman koji sam ja predložila i nije bio uvršten, ili nije bio uvršten u samo izmeni zakona. Toliko!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë dua t'i referohem raportit të Komisionit ku thuhet se Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim, në afatin e përcaktuar me

Rregullore të Kuvendit, neni 57 pika 8, nuk e ka shqyrtuar raportin me rekomandime dhe i njëjti procedohet në Kuvend pa raportin e Komisionit për të drejtat e komuniteteve dhe kthim, kështu që ne po procedojmë e në qoftë se ka ankesa mund të bëhen pastaj sipas rregullave të Rregullores së Kuvendit dhe ligjeve në fuqi.

Ky projektligj i ka gjithsej 6 amendamente.

Amendamenti 5 propozuar nga Komisioni për Buxhet e Financa me përkrahjen e Komisionit Funksional.

Vazhdojmë me votimin.

Amendamenti 1

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Për amendamentin 2, pati diçka zonja Halimi!

62 deputetë janë në sallë.

Zonja Halimi, e keni fjalën!

SELVIJE HALIMI: Faleminderit nënkryetar!

Te amendamenti 2, është bërë një lëshim teknik, andaj kërkoj vëmendjen e deputetëve që ta dëgjojmë.

Amendamenti 2, neni 7, paragrafi 1 i Projektligjit riformulohet si vijon: “Sekretaria e ka drejtorin dhe zëvendës drejtorin. Drejtori dhe zëvendës drejtori emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga kryeministri, me mandat pesëvjeçar, pa të drejtë rizgjedhje”.

Neni 7, paragrafi 3 Projektligjit fjalët “të këtyre pozitive” hiqen dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Do të thotë, është vetëm si rregullim teknik dhe kërkoj që të votohet kështu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë po votojmë me elektronikë këto çështje që i propozoi zonja Halimi për ndryshim dhe votojmë tani, pra amendamentin 2.
Ju lus të votoni!

Ju lus edhe një herë ta keni vëmendjen në seancë dhe votimi.

Amendamenti 2, meqenëse u diskutua rreth tij, duhet të votohet me elektronikë dhe ju kisha lutur që të votoni të gjithë për, kundër ose të abstenoni.

Pra, e votojmë propozimin e zonjës Halimi, në amendamentin 2 të ligjit dhe votojmë tani:

Atëherë, nuk kalon dhe mbetet si është.

(Ndërhyrje)

Po ja, po hyjnë, sepse kanë qenë të zënë shumë!

Të pranishëm në elektronikë janë 81 deputetë, në sallë janë 70, e u shtuan edhe nja 3-4.

Atëherë, e rikthejmë në votim amendamentin 2.

Unë besoj se të gjithë e dimë rëndësinë e votimit dhe s'kam nevojë të flas asgjë. E votojmë tani edhe një herë amendamentin 2.

Nuk duan të ndryshojnë asgjë, në rregull është. Mbetet ashtu siç ishte.

Amendamenti 3

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 5 - Propozim i Komisionit për Buxhet dhe Financa me përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Ju lus që të votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Zoti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti kryesues!

Për t'u bërë seriozë se ligji besoj se është shumë serioz, unë besoj që tash. meqë më herët për arsye ose joarsye nuk ndodhte votimi me 61, para se ligji të votohet në tërësi ka mundësi që zonja e Komisionit ta japë atë formulim, sepse pa atë formulimin e saj ligji po defunksionalizohet. Të mos bëjmë gabim pas gabimi pa farë nevoje. Është momenti kur ajo mund ta artikulojë atë kërkesë dhe të votohet bashkë me tërësinë e ligjit, përndryshe s'bëjmë asgjë.

KRYESUESI: Po unë tri herë e hodha në votim, tri herë gjendja ishte e njëjtë. Në qoftë se ka deputetë që nuk duan të votojnë është problem i tyre, unë patjetër që ia jap fjalën edhe një herë në qoftë se dëshiron zonja Halimi dhe e hedh në votim. Ajo është kërkesë e juaja, pse jo.

Zonja Halimi e keni fjalën.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po e theksoj edhe një herë, është bërë një lëshim teknik dhe nuk është i përcaktuar mandati i udhëheqjes së Sekretarisë së Agjencisë së Pronave dhe me këtë lëshim teknik po detyrohem që në seancë ta bëjmë korrektimin.

Sekretaria e ka drejtorin dhe zëvendësdrejtorin. Drejtori dhe zëvendësdrejtori emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga kryeministri me mandat pesëvjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje. Do të thotë ky, është formulimi që duhet ta përmbajë neni 7, paragrafi 1 i projektligjit.

Kurse paragrafi 3 i projektligjit, fjalët “të këtyre pozitave” hiqen dhe teksti vazhdon si në projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, po pres që grupet parlamentare t’i bëjnë konsultimet.

Unë nuk po e kuptoj pse nuk po e votojnë, se është shumë e qartë se nëse nuk votohet, drejtori dhe zëvendësdrejtori mbeten të përjetshëm. Ky është ndryshimi, nuk ka diçka që e prek ligjin. Ne po deklarojmë kundër emërtimeve politike, e realisht gjithmonë i votojmë në Parlament të propozuarit nga politika, sepse Qeveria është politike, nuk është jopolitike, dhe më mirë është t’u kufizohet mandati, kjo është e logjikshme.

Zonja Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJÀ REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući!

Mislim da ove nesuglasice koje su se desile povodom ovog Zakona su bezpotrebne i između većinske zajednice i svih ostalih manjinskih zajednica, i ne bi trebalo da se dogode, dajte prostora još malo Komisiji za zajednice, mi ćemo usaglasiti svoje stavove i iznećemo. Tako da zahtevamo od predsednike parlamentarne grupa da podrže ovaj stav. Nema potrebe za ovakvim nesuglasicama u parlamentu. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë Ismet, e dëshiron fjalën?

ISMET BEQIRI: Faleminderit, nënkryetar!

Ta them të drejtën është e habitshme dhe kjo që e tha kolegja deputete nuk është asnjë arsyetim të mos e përkrahim, sepse duket propozim teknik por është shumë e rëndësishëm t’u kufizohet mandati dhe është absolutisht e pakuptueshme pse kjo nuk votohet dhe ne kemi hyrë në procedurë të votimit, e tash janë dy mundësi: o duhet të dalë dikush prej Qeverisë ta tërheqë leximin e dytë e t’i bëjmë këto konsultime, se ne si deputetë ne nuk kemi të drejtë, ose duhet dërguar në lexim të tretë. Këto janë mundësitë, përndryshe ne kemi hyrë në procedurën e votimit.

Unë kërkoj mirëkuptim, se nuk pati ndonjë arsyetim që të na bindë ne të tjerët në arsyeshmërinë e juve, kolegë të nderuar deputetë të komuniteteve, se pse nuk e përkrahni ose e nuk votoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Berisha e ka fjalën.

VETON BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Unë vetëm për sqarim, nuk është çështja që nuk po përkrahet ndryshimi i propozimit të nenit 2. Por, çështja është që ky projektligj nuk ka ardhur në Komisionin Funkcional të Komuniteteve. Këtu është çështja. Është në tërësi si projektligj që është shqetësim, është dashur të vijë në komision dhe nuk është çështja tek neni 2.

Unë mendoj që ia vlen edhe është mirë që të shtyhet për një takim tjetër të mundshëm të komisionit edhe në t'i heqim ato dilema rreth këtij projektligji, meqenëse e ka një rëndësi të veçantë, sepse mund të preken komunitetet me këtë projektligj dhe është shumë normale që komunitetet mund edhe të abstenojnë te kjo çështje. Është tejkalim dhe ne kemi të drejtë ta kemi në Komisionin për Komunitete, sepse është obligative që ky projektligj të kalojë nëpër komisionin tonë.

Ndoshta është për fajin teknik tash e një vit, por ne si komision, sepse veproj në kuadër të atij komisioni, kemi të drejtë ta kemi projektligjin në Komisionin e Komuniteteve. Nuk është çështja e nenit 2, por është çështja e krejt ligjit që normalisht mund të mos përkrahet tani këtu.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Berisha! Unë dua të informoj që ky ligj, jo që ka kaluar, po ka mrizuar në Komisionin tuaj të Komuniteteve, por se nuk është shqyrtuar dhe pse nuk ka kaluar është një çështje krejt tjetër.

Kështu që ne do ta kalojmë me votim, lërjani mandatin e pakufishëm, nuk ka problem. Fjalën e kanë kërkuar zëvendëskryeministri Shala dhe zoti Grabovci. Zoti Grabovi, e keni fjalën.

ADEM GRABOVCI: Zoti kryesues!

Për mendimin tim, nuk ka asnjë arsye që të mos votohet. Rregullat e tërheqjes së ligjeve nga deputetët i kemi të rregulluara procedurat, duhet të respektohen. Tash ne si deputetë jemi në procesin e votimit dhe nuk kemi të drejtë ta tërheqim. E vetmja mundësi është Qeveria. Prandaj, unë e kisha lutur zëvendëskryeministrin le ta tërheqë këtë ligj deri në seancën e radhës, me qëllim që të mos dështojmë.

KRYESUESI: Zoti Shala e keni fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kjo është një situatë e re edhe për Qeverinë, po që të kemi kohë edhe ne edhe ju që të sqarohemi - Qeveria e tërheq ligjin dhe e sjell në seancën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Shala, e tërhiqni krejt, apo po e shtyni? Atëherë e hedh në votim propozimin e zëvendëskryeministrit për ta shtyrë për seancën e radhës.

Kush është për? Miratohet. Kundër? Një votë është kundër. Faleminderit!

Projektligji shtyhet për seancën e radhës, kur t'i vijë radha.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL, zonjën Kajtazi, që ta paraqes dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime. Atëherë zonja Mustafa e ka fjalën, meqenëse nuk është zonja Kajtazi.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit kryesues!

Të nderuar kolegë,

Komisioni për të Drejtat e Njeriut Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në pajtim me nenet 57, 67 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit, në disa mbledhje të mbajtura e shqyrtoi raportin e Projektligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të propozuar nga Qeveria.

Ndërsa në mbledhjen e mbajtur më 17 maj 2016 vendosi që Kuvendit t'i paraqesë raportin me gjithsej 17 amendamente dhe i fton deputetët që t'i përkrahin amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Ju lus që të ktheheni në sallë dhe të duroni pa pirë kafe e duhan se vërtet kemi për ta votuar dhe është ligj me rëndësi, është ligj për kategoritë shumë të rënda.

Atëherë, procedojmë, më duket kemi mjaft deputetë, por ta shohim numrin.

I kemi 63 deputetë në sallë.

Amendamenti 1

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tani!

Në sallë i kemi 72 deputetë.

Konstatohet se me 64 vota, kundër nuk ka, një abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën e përgjithshme administrative

Komisioni për Funkcional dhe Komisioni për Legjislacion, në pajtim me vendimin e Kuvendit datë 30 mars 2016, i kanë harmonizuar qëndrimet dhe amendamentet e propozuara në Projektligjin për procedurën e përgjithshme administrative dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj raportuesin e Komisionit Funksional, deputetin Sadri Ferati, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime, të harmonizuar me Komisionin për Legjislacion. Zoti Ferati e keni fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Pra, edhe pas tentimit në leximin e dytë, ne e kthyem në leximin e tretë, me qëllimin më të mirë që t'i harmonizojmë qëndrimet ndërmjet dy komisioneve - Komisioni i përhershëm për Legjislacion dhe ai Funksional për Administratë Shtetërore, Pushtet Lokale dhe Medie. Dhe, me ndihmën edhe të ekspertëve që i kemi pasur, e që dua t'i falënderoj për kontributin e tyre, edhe nga Administrata, edhe nga ekspertët e angazhuar në bërjen e ligjeve, ne kemi ardhur te përfundimi që tani ne e kemi përpara, dhe mendoj që pas një pune të mirë ne e kemi bërë një ligj edhe është në përputhje me standardet dhe direktivat evropiane, por edhe i përshtatet realitetit dhe nevojave të Administratës sonë shtetërore. Pra, që gjithmonë lidhet me procedurat administrative.

I ftoj deputetët që ta votojnë të njëjtin.

KRYESUESI: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion nuk dëshiron, nuk e ka ndonjë diskutim të rëndësishëm.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit Funksional. I kemi 48 amendamente:

Në sallë kemi deputetë të mjaftueshëm, 72 janë të pranishëm.

Amendamenti 1

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 32

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 33

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 34

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 35

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 36

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 37

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 38

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 39

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 40

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 41

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 42

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 43

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 44

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 45

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 46

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 47

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 48

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Tani e votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe ju të nderuar deputetë për votim. Në sallë janë 73 deputetë. Votojmë tash! Faleminderit!

Konstatoj se me 71 vota për, një abstenim, asnjë kundër, Kuvendi e miratoi Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative.

6. Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2015

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zonjën Balje, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Komisija za poljoprivredu i sredinu na osnovu člana 72. Pravilnika skupštine, na održanom sastanku 10. 5. 2016. godine raspravljala godišnji izveštaj rada Agencije za menadžiranje memorijalnih kompleksa Kosova.

Komisija je glasala, i pored toga što smo imali izveštaj Komisije za budžet, preporučuje Skupštini na usvajanje.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Osmani, kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës e ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2015.

Sipas të dhënave të kërkuara, raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar, ndryshime që kanë ndodhur gjatë vitit, si dhe të gjitha të dhënat për shpenzimet e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe krahasimit me vitet paraprake.

Buxheti fillestar i ndarë për agjencinë për vitin 2015 ka qenë 2 milionë e 393 mijë e 308 euro. Ndërkaq buxheti përfundimtar i agjencisë ka qenë një milion e 812 mijë e 248 euro 56 centë. Duke përfshirë ndryshime që ka ndodhur në rishikimin e Buxhetit dhe shkurtimet sipas vendimit të Qeverisë dhe transferi i mjeteve buxhetore me vendimin e Kuvendit prej 20 mijë eurove nga buxheti i agjencisë në komunën e Gjakovës, nga kjo shumë janë shpenzuar një milion e 811 mijë e 513 euro, apo 99,55% të buxhetit.

Buxheti i shpenzuar sipas kategorive ekonomike ka qenë për paga dhe mëditje 100%, për mallra dhe shërbime 98,25%, për shpenzime komunale 100%, shpenzime kapitale 100%, ndërkaq nuk ka pasur të ndarë buxhet për subvencione dhe transfere.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 27. 4. 2016, pasi e shqyrtoi raportin vjetor financiar të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë, vlerësoi se

raporti i përmbush obligimet ligjore për raportim që dalin nga ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i rekomandon Kuvendit për miratim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i PDK-së, zonja Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë dhe ka ardhur në përfundim t'i përkrahë rekomandimet e dy komisioneve funksionale, Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor për miratimin e këtij raporti.

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë është një institucion i pavarur që i raporton Kuvendit. Nëse shikohet numri dhe struktura e të punësuarve në këtë agjenci, atëherë nuk i plotëson kushtet as të jetë një departament në kuadër të një ministrie. Agjencia i ka gjithsej 11 të punësuar, përfshirë këtu drejtorin e emëruar nga Kuvendi dhe dy ciceronët.

Me një strukturë të tillë të të punësuarve është e pamundur të arrihet misioni i këtij institucioni.

Qëllimi i formimit të kësaj agjencie është projektimi, ndërtimi, administrimi dhe menaxhimi i komplekseve memorialë. Nëse e shikojmë ligjin dhe ndalemi të neni 4 - kompetencat e agjencisë, dhe e analizojmë raportin, shohim se shumë nga kompetencat të cilat i ka kjo agjenci, si dhe qëllimin për të cilin është formuar, nuk janë realizuar.

Edhe 17 vjet pas lufte në Kosovë varrezat e heronjve që na e sollën lirinë janë të pandërruara. Nuk dua të përmend memorialët e shumtë që po shkatërrohen në Drenicë e Dukagjin dhe kudo nëpër Kosovë, dua të përmend varret e dy heronjve, gjeneral Jashar Salihu dhe gjeneral Xheladin Gashi - Plakut, në Kompleksin e Dëshmorëve në Prishtinë, vetëm pak metra larg nga kjo ndërtesë e Kuvendit. Është shumë e pakuptueshme si janë ndarë këto varre nga Varrezat e Dëshmorëve dhe kanë mbet të pandërruara? Rregullimi i varrezave të këtyre dy heronjve nga shokët e luftës nuk u bën nder institucioneve që janë kompetente për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e komplekseve memorialë.

Ligjit për komplekset memorialë i është bashkëngjitur edhe shtojca, ku janë të shënuara të gjithë memorialët që duhet të mirëmbahen nga kjo agjenci. Shtrohet pyetja, a po mirëmbahen këta memorialë?

Të gjithë jemi dëshmitarë të realitetit se memorialët që janë ndërtuar po shkatërrohen nga mosmirëmbajtja. Atëherë shtrohet pyetja, pse kemi formuar agjenci dhe atë të pavarur?

Nëse e kemi përcaktuar qëllimin dhe misionin me ligj, atëherë duhet edhe ta forcojmë institucionin që të arrijë t'i realizojë objektivat për çka është themeluar, por edhe të kërkojmë llogaridhënie pastaj për punën që ka bërë një institucion përkatës.

Nëse agjencia mbetet kështu e pafuqizuar me personel dhe pa mjetet e duhura për mirëmbajtje të memorialëve, atëherë ky institucion është themeluar kot.

Nëse e shikojmë strukturën e planifikimit të mjeteve në pjesën e raportit financiar që i është bashkëngjitur këtij raporti të punës, vërejmë se 94% e mjeteve të agjencisë janë planifikuar për investime kapitale për këtë institucion. Por, në këtë institucion ende nuk janë bartur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mjetet për investime kapitale në memorialët e heronjve tanë edhe tre vjet pas themelimi të këtij institucioni.

Agjencia ka pasur nën menaxhim 2 milionë e 393 mijë e 308 euro të planifikuara në fillim të vitit. Ajo ka shpenzuar një milion 811 mijë e 513 euro, që do të thotë ka shpenzuar 75, 69% të mjeteve të planifikuara në fillim të vitit.

Meqenëse për këtë institucion 94% e mjeteve janë të planifikuara për investime kapitale, për kategoritë tjera paga dhe mëditje mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale janë planifikuar vetëm 6% e mjeteve. Me një planifikim të tillë dhe me një buxhet të tillë është e pamundur të arrihet qëllimi që është përcaktuar me ligji i këtij institucioni.

Ne si Kuvend duhet ta rishikojmë me kujdes, duam të kemi Agjenci për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë, apo nuk duhet të kemi. Nëse duam dhe ka arsyeshmëri të ekzistojë një institucion i tillë, atëherë ta forcojmë këtë agjenci për t'i kryer obligimet ligjore për të cilat është themeluar. Nëse jo, atëherë ta ndryshojmë ligjin dhe ta zgjedhim problemin e menaxhimit të memorialëve dhe komplekseve memorialë në përgjithësi në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Adem Salihaj, në emër të LDK-së, e ka fjalën.

ADEM SALIHAI: Faleminderit!

Përshëndetje, të nderuar deputetë,

Ne dhe gjatë vitit të kaluar kemi diskutuar shumë rreth këtij raporti dhe kemi theksuar se kjo agjenci, në fakt, me buxhetin që ka pasur dhe kushtet që ka pasur është kujdesur vetëm për kompleksin memorial në Prekaz dhe nuk ka pasur as kapacitete, as buxhet që të kujdeset për komplekset tjera memorialë.

Gjatë vitit të kaluar, megjithatë, është bërë një përparim, është ndarë pak më shumë buxhet dhe përveç Kompleksit Memorial në Prekaz, ka filluar ndërtimi edhe i tri komplekseve të tjera, ndër të cilët edhe Kompleksi Memorial në Koshare, por që as përafërsisht nuk është afër që të kryhet, ose të përfundojnë punët e këtij kompleksi memorial. Janë edhe dy komplekse tjera në të cilat po punohet, e të cilat kanë filluar të ndërtohen para se të krijohet kjo agjenci. Në fakt, ne e kemi një problem serioz lidhur me çështjen e komplekseve memorialë, jo me agjencinë, por ndoshta me vetëdijen tonë, sepse nuk ndajmë buxhet të mjaftueshëm që të menaxhohet me të gjitha komplekset memorialë ekzistues, të cilët mund të themi mbi 90% janë të luftës së fundit, por që nuk kemi asnjë kompleks pothuajse memorial të luftërave të mëparshme, përfshirë kryengritjet shqiptare të vitit 1912, përfshirë Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, përfshirë periudhat e mëhershme ose të mëvonshme.

Në fakt, sa u përket komplekseve memorialë, ose vlerësimit të tyre, nuk e kemi një kujtesë historike lidhur me këto dhe nuk kemi askund, jo përkujdesje, por as komplekse memorialë, gjë që e tregon një defekt serioz në ndërgjegjen tonë kombëtare dhe shtetformuese.

Prandaj, unë mendoj që në të ardhmen Qeveria dhe Kuvendi duhet ta ndryshojnë konceptin e funksionimit të kësaj agjencie, por edhe konceptin e ndërtimit të komplekseve memorialë, sepse shumë çështje as që janë trajtuar nga historianë, as nga institucione të ndryshme dhe ne nuk i dimë saktësisht ngjarjet që kanë ndodhur: kush është vrarë aty, cilët janë emrat etj., etj. Ne e kemi ndërtuar para shumë vitesh një përmendore të vogël të Mic Sokolit dhe Sefë Koshares, që as përafërsisht nuk i plotëson kushtet, duke marrë parasysh që këto janë dy figura tepër të mëdha kombëtare dhe e meritojnë një trajtim krejt ndryshe.

Në fakt, agjencia nuk ka mundësi të menaxhojë me këto çështje, siç u tha i ka vetëm 11 të punësuar, prej tyre 7 janë në pozita udhëheqëse dhe vetëm 4 janë ndoshta punëtorë që mund t'i kryejnë aty disa punë dhe problemet kryesore gjatë mandatit para këtij kanë qenë se këta s'kanë pasur as zyrë ku të punojnë, por kanë punuar diku në ambientet e Kuvendit të Kosovës. Tash e kanë njëfarë objekti, por, megjithatë, nuk janë afër që të mund ta realizojnë si duhet misionin ligjor që e kanë sipas Ligjit për komplekset memorialë.

Unë mendoj që ne në të ardhmen duhet të punojmë ndryshe, Qeveria të ndajë shumë më shumë buxhet që së paku këto komplekset e mëdha që i kanë dhënë vulë luftës së fundit të përfundohen dhe të mendojmë edhe për komplekset tjera, periudhat e mëparshme historike, sepse pa një kujtesë historike në fakt ne as që mund të ecim përpara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Abdyl Ymeri.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Monumentet, përmendoret dhe komplekset përkujtimore u ngrehën për t'i përkujtuar dhe nderuar me respekt, për t'i lartësuar dhe përjetësuar kujtimet dhe veprat sublime të dëshmorëve dhe martirëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Disa prej tyre janë ngrehur dhe financuar nga Qeveria e Kosovës, disa tjera nga komunat, përderisa disa të tjera janë nisma private. Memoriali i Jasharëve është destinacion kombëtar pelegrinazhi, veçanërisht për shqiptarët nga e gjithë gjeografia shqiptare, e pse jo edhe vizitorët e huaj. Prandaj, e do një përkujdesje të veçantë nga institucionet e vendit.

Raporti, në përgjithësi, është analitik dhe e ka një strukturë mirë të ndërtuar që paraqet secilin aktivitet që e kryen agjencia, si dhe në mënyrë detale paraqiten të gjitha të dhënat e buxhetit të planifikuar dhe të shpenzuar. Nëse misioni është krijimi i mundësisë për funksionimin e agjencisë në pajtim me ligjin në fuqi, duke u bazuar në planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe menaxhimin e komplekseve memorialë të Kosovës dhe është kompetent për të gjitha komplekset dhe memorialët e Kosovës, unë konsideroj se kësaj agjencie i duhet një mbështetje më e madhe financiare për ta përmbushur këtë mision.

Ajo që unë nuk e vërej në raport është se nuk e kemi një listë të përgjithshme të komplekseve memorialë, të ndërtuara anembanë Kosovës, dhe cila është gjendja e tyre, sepse ka tre vjet që është themeluar kjo agjenci dhe besoj që kjo është një nga detyrat që duhet përmbushur. Ne e kemi një numër jo të vogël të komplekseve memorialë, të ndërtuara dhe financuara nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, por po që se e vizitoni do ta shihni se nuk kanë mirëmbajtje dhe përkujdesje nga askush. Nuk ka asnjë përgjegjës për mirëmbajtjen e tyre, përpos ndonjë njeriu vullnetar, i cili me vullnetin e tij i pastron dhe i rregullon ato.

Ndërtesa në të cilën gjatë luftës ishte i vendosur Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Likoc mbeti i shkatërruar, por në vitin 2008, me një projekt të Qeverisë së Kosovës, ndërtesa u restaurua. Ky objekt ka rëndësi të veçantë dhe është një histori për Kosovën, sepse aty zhvilloheshin bisedimet e përfaqësuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me të deleguarit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të BE-së dhe NATO-s. Në Likoc të Drenicës, në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së kishin zbritur ambasadorët Kristofer Hill e Volfgang Petriç, që vlerësohej se e arritura më e lartë e internacionalizimit të çështjes së Kosovës dhe krijimit të aleancës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, BE-në dhe NATO-n.

Qendra e të gjithëve u bë Likoci dhe nga aty drejtohet lufta çlirimtare. Sot ky objekt është pa përkujdesje institucionale. Fehmi Kadriu që përkujdeset, punën e bën vullnetarisht, prandaj ne duhet ndihmuar agjencinë në mënyrë që të gjitha komplekset memorialë t'i marrë në përkujdesje dhe ta punësojë nga një punëtor që do t'i mirëmbajë dhe përkujdeset për ato.

Po ashtu, duhet të barten të gjitha projektet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimin Hapësinor të Agjencia për Mbikëqyrjen e Komplekseve Memorialë, e besoj se këto është dashur të jenë në kuadër të rekomandimeve të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sa herë që e kemi në shqyrtim raportin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë, ne edhe viteve të kaluara i kemi bërë vërejtjet me shpresën që pas miratimit të ligjit 2013, që vërtet menaxhimi i këtyre komplekseve të jetë më i mirë dhe përveç listës, të cilën e kemi miratuar me ligj, kam pritur që brenda kësaj periudhe kohore agjencia t'i paraqesë edhe objektivat e së ardhmes se si mendon dhe cilat janë projektet e saj.

Raporti parasheh dhe e përshkruan vetëm atë çka është bërë, për çka edhe parafolësit, por edhe të gjithë diskutuesit, edhe në raportet e kaluara kanë bërë vërejtjet e tyre për arsye se askush nuk është i kënaqur me menaxhimin e komplekseve memorialë. Nëse kjo agjenci nga udhëheqësit e saj për tre vjet nuk ka arritur të kompletohet dhe i ka vetëm 11 të punësuar, si mendon në të ardhmen të realizohen projektet e kësaj agjencie dhe cilat janë pritjet e qytetarëve, në veçanti edhe të familjarëve, të cilët i kanë më të dashurit e tyre në këto komplekse? Cili është mesazhi që ne e përçojmë të fëmijët tanë kur shkojnë t'i vizitojnë këto komplekse memorialë, kur ato janë tërësisht të shkatërruara, e besa në disa nga ato as nuk vërehet fare dora e njeriut.

Unë po e theksoj njërin nga komplekset memorialë, i cili është në Polac, e ku janë të varrosur mbi 200 dëshmorë, e aty ndodhen eshtrat edhe të dy gjeneralëve, Ilaz Kodra dhe Mujë Krasniqi. Derisa ne, i nderuar nënkryetar Haliti, i kemi lënë në këtë formë Varrezat e Dëshmorëve në Polac, nën drurë, të dy gjeneralëve të luftës, atëherë si mund ta votojmë një raport të këtij komisioni kur për tre vite nuk ka arritur ta bëjë as më të voglën që ky kompleks memorial i dëshmorëve në Polac dhe shumë të tjerë ta kenë një gjendje shumë më të mirë. Të investohet në to dhe të mirëmbahen në mënyrën më të mirë, ashtu siç e meritojnë dëshmorët.

Dhe, derisa ka varreza të gjeneralëve me drurë te koka, pa i prekur dora e njeriut, dora ime nuk do të votojë raporte të kësaj agjencie.

Duhet të precizohet dhe të saktësohet a dëshiron dhe a ka kapacitet kjo agjenci që t'i mirëmbajë komplekset memorialë, apo duhet të heqë dorë dhe është në dorën e ne deputetëve të orientohemi a duam ta lëmë këtë agjenci të funksionojë kështu sa për të marrë paga 11 të punësuar atje, apo ta ushtrojmë misionin të cilin ia kemi dhënë me ligj? Dhe, ne e kemi për obligim që t'u krijojmë kushte, por besoj që me miratimin e buxheteve e kemi bërë një gjë të tillë, ndërsa një paaftësi në menaxhim të tij, më nuk është e tolerueshme. Prandaj, vota ime do të shkojë kundër këtij raporti.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muja e ka fjalën.

SHAIPI MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ne jemi në komision dhe e kemi miratuar këtë raport që të vijë në seancë plenare dhe duke shpresuar se deputetët e kanë lexuar raportin dhe i kanë kuptuar adresimet e shqetësimeve të agjencisë mbi bazën e prononcimeve që po i dëgjojmë, siç duket nuk i kanë lexuar një pjesë e deputetëve dhe problemi nuk parashtrohet te keqmenaxhimi nga stafi i agjencisë, por janë probleme të cilat mu ne deputetët duhet t'i miratojmë ose ta rritim një aktivitet më të madh për ta shtuar buxhetin dhe të shihen obligimet, qoftë nga agjencia, qoftë nga komunat, apo monumentet historike që janë të shpërndara nëpër komuna.

Prandaj, nuk jam dakord me deputetët të cilët thonë se është në keqmenaxhim, është problemi me financimin, sepse janë shumë monumente të radhitura në raport që për shkak të mungesës së financimit nuk mund t'i menaxhojë. Kur nuk ka financa, me çka do të menaxhojë? Sot, Kullat e Jasharëve janë dy kulla për të cilat kërkohen 4-5 milionë euro të investohen për konservim, e ato janë duke u shkrirë. Prandaj, më me shqetësim ishte dashur të diskutohet për dy Kullat e Jasharëve, të cilat janë jashtëzakonisht të atakuara prej kushteve atmosferike, se sa të thuhet nëse po menaxhohet, sepse agjenci nuk ua garanton paratë. Paratë i kemi miratuar ne këtu në seancë kur është miratuar buxheti, prandaj ky raport duhet të miratohet, por ne komision, së bashku me ndihmën e deputetëve tjerë, të gjenden edhe kushte të cilat, ose nëpërmjet donatorëve, ose nëpërmjet rishikimit të buxhetit të Qeverisë, në qershor tash të alokohen mjete, bile së paku të konservohen deri në masën kur nuk mund të shndërrohen në gërmadha nesër Kullat e Jasharëve.

Ka monumente të tjera, të cilat fatkeqësisht janë duke u shkatërruar për shkak edhe të raporteve, ndoshta të relacioneve që kanë qenë, edhe atyre ekzistuese me Ministrinë e Ambientit dhe me drejtuesit e komunave, prandaj komunat në një mënyrë duhet të marrin edhe ato obligime në bashkëpunim edhe në koordinim që për disa shkallë të përkujdesen për bustet, për pastrimin e tyre, për disa çështje. Ndërsa, monumentet që kërkojnë edhe ciceron, ne folëm këtu që me dy

ciceronë në Prekaz nuk mund të mirëmbahet as informimi publik i vizitorëve, por nuk mund të mirëmbahet as memoriali.

Janë edhe memorialët tjerë, të cilët kërkojnë ndihmë të tillë, prandaj objektivisht duhet të bisedojmë, e jo në mënyrën vetëm sa për të thënë, sepse raporti me këto mjete të cilat i posedon kjo agjenci, dhe me këtë kapacitet të personelit, nuk mund t'i menaxhojë. Ne jemi përgjegjës, nuk është agjencia. Prandaj, agjencinë ne e kemi miratuar dhe për atë duhet t'ia miratojmë edhe këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhiu, replikë me zotin Muja.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Jo që s'e kemi lexuar raportin, por e kemi analizuar shumë mirë dhe nuk ka pak mjete kjo agjenci në menaxhim, janë 2 milionë e 393 mijë e 308 euro për vitin 2015 dhe prej tyre janë 78 mijë e 558 euro vetëm për paga dhe mëditje dhe nëse e marrim një mesatare prej 400 eurove, nëse të punësuarit në këtë agjenci do ta kishin një pagë kaq, atëherë sigurisht që kjo shumë do ta kalonte numrin e të punësuarve, dhe është papërgjegjësi e atyre që janë në udhëheqje të kësaj agjencie që nuk kanë arritur të realizojnë kapacitetet e tyre.

Ne mund të bëjmë letra këtu çfarë të duam, por gjendja në terren është ajo që është. Ashtu siç e paraqiti edhe parafolësi, edhe shumë të tjerë, ashtu edhe si e thamë, ne mund të flasim këtu dhe letra të sjellim çfarë të duash, por në Varrezat e Dëshmorëve në Polac gjendja është shumë e rëndë, e papranueshme, prandaj edhe kërkesa jonë është që në projeksionet e kësaj agjencie duhet të na vijnë në Kuvend që këto të realizohen dhe të jenë në nivelin çfarë e meritojnë dëshmorët.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Muja.

SHAIP MUJA: Unë, pa dashur që zoti Haxhiu t'i përdorë këta numra të financimeve, dhe pa dashur të hyj në detaje në varrezat e ndryshme, për shembull edhe te varrezat në Polac, ne në komision i kemi diskutuar. Ato duhet të transferohen në Marinë, prandaj edhe për varrezat në Marinë jemi ne përgjegjës, jo agjencia, nëse hyhet andej, për të mos e mundur tash krejt Parlamentin me këto konkludime.

Unë mendoj që nuk është se agjencia s'ka kryer punë, por ne duhet të bisedojmë edhe në Komisionin Funksional ku jemi, por edhe të kërkohej ndihmë me propozimin e këtij Kuvendi që Qeveria ta shohë më seriozisht problemin e monumenteve historike, në të kundërtën një shtet i cili nuk investon, jo vetëm në të veçantat, por në të përgjithshmen, në histori, ne do të mbetemi të na e shkruajnë të tjerët historinë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Sa herë na vjen ky raport, niveli i diskutimeve pothuajse është i njëjtë, sepse ndryshime ka shumë pak.

Mandatin e kaluar kur kemi diskutuar për çështjen e memorialëve, shpeshherë kemi hasur në dilema dhe keqkuptime që pastaj kanë vazhduar më shumë si debate nëpërmjet portaleve, e jo aty ku duhet të debatohet. Unë mendoj që Agjencia për Menaxhimin dhe Mbikëqyrjen e Memorialëve duhet përfundimisht ta sjellë një listë të kompletuar të memorialëve në Kosovë dhe ne të dimë saktë se cilët memorialë kjo agjenci i ka nën mbikëqyrje, sepse e tha shumë mirë edhe zoti Ymeri, por edhe parafolësit e tjerë, që këta memorialë apo këto monumente janë të ndërtuara ose thjesht të investuara nga aktorë të ndryshëm, deri edhe te ata me vetiniciativë.

Është shumë e vërtetë ajo çka e tha edhe zoti Bekim Haxhiu, sepse kur shkojmë në Polac ndihemi të turpëruar edhe para varrezave, të cilat gjenden aty, por edhe sa herë takohemi me familjarët e tyre, meqë ata me të vërtetë kërkojnë një trajtim të dinjitetshëm dhe thjesht ne e dimë procedurën që dëshmorët që janë në varrezat e Polacit do të barten në Kompleksin Memorial në Marinë, por edhe ky kompleksi memorial i Marinës është bërë në njëfarë mënyrë si Ura e Shenjtë dhe kurrësi nuk po e gjen përfundimin. Duhet të caktohet një afat kohor se kur do të përfundojë ky episod, sepse me të vërtetë është e mundimshme edhe për familjarët, edhe për ne, edhe për të gjithë Kosovën që të shihet trajtimi jo i dinjitetshëm i Varrezave të Dëshmorëve.

Është e turpshme kur shkojmë nëpër komplekse memorialë dhe shohim nga një gjysmë flamuri të varur nëpër ato komplekse dhe thjesht sikur na thërret në ndërgjegje një veprim i tillë. Unë mendoj që kjo agjenci përfundimisht duhet ta sjellë një raport, ose thjesht të vijë me objektivat e qarta se çka pretendon të bëjë. Kë e ka thjesht në menaxhim? Ende nuk i din detyrat e veta, të cilat duhet t'i kryejë. Nuk mund të kërkojë ndihmë pa e sqaruar ose thjesht pa e argumentuar pse e kërkon ndihmën. Pajtohem plotësisht që duhet të përkrahet kjo agjenci nëse dëshirojmë ta kemi nivelin e kënaqshëm të këtyre memorialëve.

Dua të pajtohem plotësisht me parafolësin zotin Muja, i cili e përmendi jorastësisht gjendjen jo të mirë të dy shtëpive ose Kullave-muze tashmë të Familjes Jashari. E kam thënë edhe herën e kaluar, dua ta përsëris edhe tash: nuk mjafton në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" të mbillet bar, lule dhe beton. Aty duhet urgjentisht të ndërmerret diçka që të bëhet konservimi i shtëpive. Ne ende nuk e kemi një kërkesë nga kjo agjenci, qoftë ne, qoftë Qeverisë, se sa kushton ose cili është plani për konservimin e këtyre shtëpive. Ne rrezikojmë ta humbim një pjesë të historisë shumë të shenjtë të vendit tonë.

Prandaj, mendoj që është momenti i fundit që kjo agjenci ta sjellë të detajuar listën e memorialëve që janë nëpër Kosovë dhe thjesht ta sjellë kërkesën e bazuar për mbështetje. Jam shumë e bindur që asnjë deputet, edhe ne që folëm, edhe ata që nuk folën, nuk do ta votojnë kundër ndihmën për këtë agjenci, por thjesht duhet përfundimisht të sqarohet pozita e saj. Përndryshe, ne do të kemi çdo vit debate të tilla dhe asnjëherë rezultate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muja, replikë prapë.

SHAIPI MUJA: Zoti kryesues,

Në raport, në pikën E, quhet në investimet kapitale, duhet lexuar janë nja dhjetë fjali, në të cilat paraqiten investimet kapitale dhe mungesa e pjesës financiare.

Prandaj, po them ne o duhet të flasim si është situata, o nuk duhet të flasim fare. Buxheti fillestar për shfrytëzimet kapitale është 2 milionë e 250 mijë, buxheti me rishikim buxhetor në vitin 2015 është 2 milionë e 230 mijë, ndërsa buxheti final ka qenë 1 milion e 600 mijë. Domethënë, ka pasur një planifikim. Transferi i mjeteve buxhetore prej 20 mijë euro është bërë nga buxheti i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, përkatësisht nga projektet kapitale Kompleksi Memorial “Adem Jashari” Prekaz-Skenderaj me kod 13851, në buxhetin e Komunës së Gjakovës për vitin 2015.

Në projektin kapital, projekte të ndryshme kapitale me bashkëfinancim në kodin 41023, programi buxhet dhe financa, nënprogrami i buxhetimit 175160, mjetet janë shpenzuar për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” dhe për mirëmbajtjen e Kompleksit Memorial “Adem Jashari”, Prekaz-Skenderaj.

Ndarja finale e buxhetit thotë: në kategorinë e investimeve kapitale është ndryshuar pas kërkesës së agjencisë në Ministrinë e Financave për transferim të mjeteve nga kapitale në komunal në vlerë prej 227 mijë e 342. Prandaj, problemi esencial është te mjetet, edhe te menaxhimi. Nuk është te keqmenaxhimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Deliu e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Pothuajse çdo vit që ne diskutojmë për raportin e Agjencisë për Përkujdesjen e Monumenteve dhe jemi të njëjtit deputetë që i ngremë pothuajse çdoherë të njëjtat shqetësime. Nuk mendoj që u bë shumë fjalë për keqpërdorim, sa është diskutuar në lidhje me një moskoordinim të saktë që ka ekzistuar në këtë agjenci, sepse çdo seancë që kemi diskutuar, deputetë e asaj zone i kemi ngrehu pothuajse njëzëri shqetësimet e njëjta. Janë 200 dëshmorë që prehen në varrezat e Polacit dhe të cilët vërtet, u tha edhe nga parafolësit dhe kolegët e mi, janë varrezat në një gjendje të mjerë dhe pa asnjë përkujdesje institucionale.

E kur marrim parasysh se aty prehen heronjtë e mëdhenj, siç janë: Ilaz Kodra, Rasim Kiçina, Mujë Krasniqi, Rifat Mziu, e shumë e shumë dëshmorë që e kanë dhënë jetën për lirinë që ne po e gëzojmë sot, mendoj që është obligim yni që njëherë e përgjithmonë ta rregullojmë këtë çështje. E di që ka pasur një moskoordinim ndërmjet komunave dhe Agjencisë për Mbrojtjen e Monumenteve, por mendoj që ky koordinim duhet të rregullohet, sepse vonesat 16-vjeçare në rregullimin e këtyre varrezave janë arsyetuar se do të ketë një bartje prej Polacit në fshatin Marinë, vonesë e cila është neglizhuar për 16 vjet me radhë.

Prandaj, konsideroj që në fund Agjencia për Mbrojtjen e Monumenteve të jetë më e vëmendshme karshi kësaj problematike të madhe, karshi obligimit tonë si deputetë dhe si qytetarë të këtij vendi që ta sigurojmë një përkujdesje meritore për varrezat dhe për të gjitha monumentet që ekzistojnë në nivel të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqë kur është themeluar kjo agjenci në vitin 2013, kam qenë në at komision dhe atëherë kanë qenë dilemat e tilla, sidomos sa i përket stafit të kësaj agjencie dhe njëkohësisht sa i përket edhe buxhetit për këtë agjencie, edhe pse ajo ka të bëjë me menaxhimin e komplekseve memorialë të Kosovës në tërësi. Unë kërkoj që trajtimi i këtyre memorialëve duhet të jetë i barabartë, sepse u pa që në të shumtën e rasteve, në fjalimet që diskutuan deputetët, pak ishin lokalistë, por mendoj që kjo çështje dhe ky trajtim duhet të jetë i barabartë në gjithë territorin e Kosovës dhe e dimë shumë mirë që Varrezat e Dëshmorëve dhe njëkohësisht memorialët, të cilët tashmë kanë emërtim të saktë, nuk e kanë një trajtim të barabartë.

Unë kam kërkuar edhe në diskutimin dhe në raportet të cilat kanë ardhur edhe gjatë viteve të kaluara, është përmendur edhe Memoriali për Presidentin Rugova, i cili është futur në agjendë, por asnjëherë nuk është ndarë buxhet dhe asnjëherë nuk është iniciuar që të bëhet diçka në këtë drejtim. Prandaj, secili memorial e ka rëndësinë e vetë, qoftë ai në Skenderaj, Drenas, apo në Malishevë, por mendoj që trajtimi duhet të jetë i barabartë dhe kërkoj që edhe nga Qeveria e Kosovës që të ketë buxhet më shumë për menaxhimin e komplekseve memorialë të Kosovës dhe njëkohësisht nëse këtë agjenci dëshirojmë ta kemi të fuqizuar duhet t'i ndihmojmë që ajo të kompletohet edhe më staf mëtutjeshëm, sepse e dimë mirëfilli që është mungesa e këtij stafi dhe njëkohësisht e ka shumë problematike që të merret me menaxhimin e komplekseve memorialë në nivel të Kosovës.

Duhet të jetë një koordinimi më i madh ndërmjet kuvendeve komunale dhe në këtë rast agjencisë dhe njëkohësisht kjo urë lidhëse duhet të lihet edhe me Qeverinë e Kosovës që të ndihmohet dhe të bëhet akoma më shumë për menaxhimin e komplekseve memorialë të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë? Bekim Haxhiu replikë, s'ta përmendi emrin më duket kurrkush, por ok!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Po dua vetëm ta plotësoj deputetin Morina, në Varrezat e Dëshmorëve në Polac janë dëshmorët nga e gjithë Kosova, nga anekënd trojet shqiptare dhe nuk janë dëshmorët lokalistë. Dëshmorët janë të Kosovës dhe asnjë ne këtu që po i ngremë këto probleme nuk e kemi për çështje lokaliste, por për një çështje, e cila është më madhore se çështjet lokaliste.

Prandaj, vetëm desha ta plotësoj që edhe kur ka qenë nevoja për të diskutuar edhe për t'i mbështetur edhe Varrezat e Dëshmorëve në Koshare dhe anekënd Kosovës, prandaj diskutimi nuk ishte i fokusuar nga ne këtu vetëm për një apo dy komplekseve memorialë, por gjendja në komplekset memorialë anekënd Kosovës është e pakënaqur dhe e papranueshme. U fokusova në Polac për arsye se janë 200 dëshmorë anekënd Kosovës aty dhe prandaj e shtrova këtë çështje. Dëshmorët janë të Kosovës, janë të gjithë popullit shqiptar dhe nuk janë lokalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Morina e keni fjalën, kundër-replikë.

SALIH MORINA: Dhe, unë po e plotësoj deputetin Haxhiu, që në kuptimin lokalizëm e thashë se u fol non-stop nga disa deputetë vetëm për Varrezat e Dëshmorëve në Skenderaj dhe në

Drenas. Edhe unë kërkoja që trajtimi të jetë i barabartë, edhe për Varrezat e Dëshmorëve në Malishevë dhe, në përgjithësi, në tërë territorin e Kosovës.

Vërejtja ime është nga që kjo agjenci do që së pari të kompletohet me stafin, sepse ne në çdo raport që na ka ardhur këtu, kemi pasur mundësi, se nuk kanë staf dhe njëkohësisht kanë paraqitur mungesë të buxhetit për trajtimin e barabartë të të gjitha varrezave të dëshmorëve në nivel të vendit.

Lokalizmi i diskutimit ka qenë se kanë qenë vetëm në dy lokalitete, në dy komuna, sepse trajtimi do të thotë, është i barabartë. Dëshmorët kudo që janë, kudo që kanë rënë, janë të gjithë territorit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, po e qes në votim, deputetë kemi mjaft, raportin vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë për vitin 2015.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim! Votojmë tani!

Në sallë kemi 70 deputetë.

Atëherë, konstatoj që me 48 vota për, 3 vota kundër, 14 abstenime, Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Agjencisë për menaxhimin e komplekseve memorialë të Kosovës për vitin 2015.

7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit të Pavarur për Medie për vitin 2015

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Medie për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Medie 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional... kush e ka fjalën tash, Zenun Pajaziti, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie në bazë të nenit 67 dhe 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më datën 4.5.2016 shqyrtoi raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Medie për vitin 2015 dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim.

Rekomandimi është që të miratohet raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Medie për vitin 2015.

Ky raport është kryesisht i plotësuar me të gjitha aktivitetet e këtij institucioni. Ka të dhëna për politikën e transmetuesve, dhënien e licencave, të ankesave, sanksioneve që zbatohen dhe vendimet në lidhje me ato, aktivitetet financiare, si dhe aktivitetet tjera të këtij mekanizmi, të këtij autoriteti.

Dëshiroj të theksoj po ashtu, që ky raport i radhës i këtij institucioni i Komisionit të Pavarur për Medie paraqet një stabilitet të këtij asociacioni, të këtij autoriteti. Ka të dhëna të plota për angazhimin vjetor të Komisionit të Pavarur për Medie. Vlen të theksohet, që ky autoritet ka marrë përgjegjësi të reja vitin që shkoi, për sa i përket një procesi të rëndësishëm, që është digjitalizimi. Ne e dimë, si Kuvend kemi aprovuar edhe një strategji dhe ky institucion është i angazhuar për aprovimin, për zbatimin e kësaj strategjie. Në komision na kanë parashtruar edhe pengesa të tjera shtesë, që lidhen me financat. Pra, ka mangësi, ose ka sfida, që ky autoritet përballet.

Unë ftoj Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe atë për Mbikëqyrjen e Financave Publike, që ta trajtojnë, t'i trajtojnë kërkesat dhe shqetësimet e këtij autoriteti, në mënyrë që në periudhën në vijim këta të mos kenë pengesa, që të mund ta ushtrojnë aktivitetin e vet në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë që i kanë marrë gjatë kësaj periudhe. I ftoj deputetët që ta aprovojë këtë raport. Faleminderit!

KRYSUESI: Faleminderit! Zoti Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Zoti Osmani, e keni fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Ky raportim i këtij llojit, konsideroj se duhet ndryshuar, sepse duhet trajtuar raportin në tërësi nga komisionet funksionale, që të mos ketë raportime të dyfishta nga komisionet e ndryshme. Por, megjithatë Komisioni i Pavarur për Medie ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2015 sipas të dhënave të kërkuara. Raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar, ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit, si dhe të dhënat për shpenzimet e buxhetit, sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike, të krahasuara me periudhën e vitit paraprak.

Buxheti fillestar i ndarë për Komisionin e Pavarur për Medie për vitin 2015 ka qenë 794 342 euro, pas rishikimit ka qenë 1 265 093 euro.

Buxheti përfundimtar ka qenë 1 254 162 euro, duke përfshirë dhe ndryshimet që kanë ndodhur me rishikimin e buxhetit dhe shpërthimet sipas vendimit të Qeverisë, nga kjo shumë janë shpenzuar 99,86% ose në vlerë absolute 1 252 431 euro.

Buxheti i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike ka qenë paga dhe mëditje 100%; mallra dhe shërbime 99,68%; shpenzimet komunale 100% dhe shpenzimet kapitale 99,86%.

Raporti para komisionit ka ardhur me disa kalkulime të pasakta, që komisioni ka dhënë një afat të caktuar Komisionit për Medie që t'i bëjë përmirësimet, që në ndërkohë i kanë prurë dhe u është prezantuar deputetëve dhe pasi që është kompletuar, komisioni i ka rekomanduar Kuvendit që ta aprovojë raportin financiar për Komisionin e Pavarur për Medie.

KRYSUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Izmaqi e ka fjalën.

XHEVAIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky raport është një raport më pak emocional sesa i kaluari, mirëpo është profesional.

Më lejoni të them, që Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar me seriozitet dhe vlerëson pozitivisht punën e Komisionit të Pavarur për Medie, i cili është një komision si organ kushtetues i përcaktuar me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Komisioni i Pavarur për Medie është organ i pavarur, rregullon fushën e menaxhimit të frekuencave të transmetimit dhe përbërja e tij është si në vijim: Komisioni i Pavarur për Medie përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët duhet të jenë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme në gazetari, në biznes, në menaxhment dhe deklaroj si anëtare e këtij komisioni që vërtet këtë radhë, që prej fillimit kur funksionon si komision, është një përbërje shumë profesionale dhe është një bord më autoritativ, i cili ka kompetenca shumë të mëdha në fushat për të cilat vepron.

Unë do të jap disa deklarata duke përfshirë evitimin e atyre financiare, sepse i dha kolegu Naser dhe gjithashtu edhe kryetar i komisionit. Pra, po filloj me sfidat të cilat i ka kaluar Komisioni i Pavarur për Medie në vitin 2015 dhe kjo në fillim ka qenë mospagesa e taksës së licencave për një numër të madh të konsiderueshëm të medieëve, mirëpo Komisioni i Pavarur për Medie nga këta 48 ofrues të shërbimeve, të cilët nuk kanë arritur t'i kryejnë obligimet ligjore, përfshirë këtu edhe transmetuesin publik, për të cilin KPM-ja ka qasje më specifike për arsye se ka një status të ndryshëm, pra e ka ligjin e vet, i ka ofruar edhe një mundësi që ata gjatë vitit 2016 t'i shlyejnë këto borxhe dhe të vazhdohet me operim normal.

Prioritet parësor i KPM-së për vitin 2016 është implementimi i strategjisë për kalim në transmetim digjital tokësor në Republikën e Kosovës. Dua të theksoj se kjo strategji ende nuk ka kaluar në Qeveri dhe unë kisha dashur që të jenë këtu ministrat përkatës të resorëve, të cilëve unë do t'ua adresoja problemet e theksuara. Duhet të kalojë strategjia për digjitalizim, në mënyrë që pastaj të kemi mundësi që ta implementojmë Ligjin për digjitalizim që do të jetë një proces jo i lehtë në vendin tonë dhe për të cilin, fatkeqësisht ende nuk e kemi asnjë cent të ndarë në buxhet dhe nuk ka kaluar asnjë shtet në Evropë procesin e digjitalizimit pa buxhet adekuat për këtë. Por, besoj që Qeveria e ka parasysh, sepse është një segment shumë i rëndësishëm.

Vlen të theksoj, kolegë të nderuar, se ky komision ka kryer një punë profesionale duke bashkëpunuar me organizata vendore ndërkombëtare duke ftuar asistencë në hartimin e legjislacionit, që është i veçantë për çështjen e digjitalizimit, mirëpo unë do ta jap një pasqyrë të shkurtër se si funksionon departamenti, për shembull, i monitorimit dhe sa është numri i televizioneve, radiove dhe operatorëve kabllorë, që operojnë në vendin tonë, sepse e kemi vetëm një herë në vit dhe besoj se ia vlen ta përcjellim.

Pra, në vitin 2015 në vendin tonë kanë operuar gjithsej: 20 radiostacione televizive; 82 radiostacione; 37 operatorë kabllorë. Sipas gjuhëve të operimit janë të ndara në këtë mënyrë: kemi 13 radiotelevizione stacione në gjuhën shqipe; 5 tv stacione në gjuhën serbe; dhe kemi 3 televizione në gjuhën turke. Të licencuara i kemi 82 radio stacione, prej të cilave 46 janë në gjuhën shqipe; 23 në gjuhën serbe; 3 radio në gjuhën boshnjake dhe 3 radio në gjuhën turke; 2 radio në gjuhën gorane; një radiostacion në gjuhën rome dhe 2 radiostacione multietnike.

Është interesant të përmendim një fakt, prej pasluftës vendi ynë nuk përdor komplet frekuencat, të cilat si shtet i pavarur ishte dashur t'i përdor, mirëpo operon vetëm me 62,7 që japin sinjal televiziv. Këtu është një çështje pak komplekse, sepse ne si vend nuk e përdorim pikën më të lartë, pra mbulimin me sinjal televiziv, që është pika e Goleshit, sepse ajo përdoret nga KFOR-i. Pra, ka pasur mundësi që të ketë një tolerancë më të madhe, sepse deri tani kemi vetëm mbulimin me 62%, ndërsa nëse do ta përdorim frekuencën më të lartë do të kishim 90% të mbulimit të frekuencave.

Unë e kam përcjellë vazhdimisht të këtij komisioni, mund të them me kompetencë, se ia vlen të vlerësohet pozitivisht dhe të votohet për. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, për raportin e ri në emër të raportuesve! Zoti Sadri Ferati në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryesues!

Do të provoj të mos i përsëris gjërat që u thanë, e që ishin shumë gjëra të mira, sepse kam qenë edhe anëtar i komisionit me ç'rast kemi pasur rastin të dëgjojmë dhe të marrim pjesë në diskutimet rreth raportit, po edhe në Grupin Parlamentar të LDK-së.

Neve na vjen mirë që ky rregullator i rëndësishëm, që e mbulon një fushë të rëndësishme, siç është rregullimi i frekuencave dhe i menaxhimit të tyre në fushën e medieve. Ka qenë një vit shumë sfidues, ku ky komision ka pasur rezultatet e veta në vetë hartimin e strategjisë, por edhe në ndihmesën e madhe që ka dhënë në hartimin e Ligjit për digjitalizim dhe ka bërë një hap shumë përpara bashkë me aktorët e tjerë, që edhe në Kosovë të fillohet vetë modernizimi dhe kalimi në sistemin digjital të transmetimeve.

Nga ana tjetër, kam marrë pjesë në shumë iniciativa dhe tani ky rregullator është anëtar i iniciativave të Mediteranit, Adriatikut, e tjera... dhe shpresojmë se shumë shpejt do të anëtarësohet edhe në ITU, me çka edhe do të krijojë kompetencën dhe autonominë e menaxhimit të frekuencave për territorin e Kosovës, por edhe do të avancojë punën e saj.

Sfidat nga raporti i kaluar, pothuajse kanë mbetur të njëjtat. Komisioni ka mungesë të buxhetit dhe si pasojë ajo ka jo kushte të mira të punës dhe nuk ka arritur të bëjë investime kapitale dhe ta modernizojë punën e saj. Ndoshta, në të ardhmen, shumë shpejt, duhet që të diskutohet në mënyrë që komisioni ta përcaktojë shërbimin e vet në raport me aktorët tjerë, të cilëve u kryen shërbime, për të mundur të krijojë fondin e vet nga të hyrat e veta, të cilat pastaj do t'i menaxhonte dhe nga të cilat do të krijonte produktet e dëshiruara.

Kështu si i tillë raporti për ne është i pranueshëm dhe tregon një punë të përkushtuar, e kemi votuar në komision, kemi diskutuar në grup parlamentar dhe tash u sugjeroj deputetëve, që ta votojnë këtë raport të punës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Atëherë, përgatitemi për votim. Sa deputetë janë në sallë? 66 deputetë janë. Votojmë tani!

Atëherë, konstatoj që me 57 vota për, 1 kundër, 5 abstenime, Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Medie për vitin 2015.

Unë besoj që është mirë që t'i miratojmë edhe dy raporte që kanë ngelur dhe të ikim pastaj. Edhe ju lutem që deputetët të mos bëhen riraportues, por të konstatojnë a ka vërejtje, a duhet ta miratojmë apo jo. Në qoftë se ka vërejtje në raport në rregull diskuto, po...

8. Shqyrtimi i raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015

Komisioni Funkcional në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Po ashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Mbështetur në nenin 29 të Ligjit 5/L-19 për Avokatin e Popullit përcaktohet: Avokati i Popullit paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës... Ftoj Avokatin e Popullit, zotin Hilmi Jashari, që të paraqesë para deputetëve të Kuvendit dhe të arsyetojë raportin vjetor. Zoti Hilmi, e keni fjalën. Mirë se erdhët! Zoti Jashari e ka fjalën!

AVOKATI I POPULLIT HILMI JASHARI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Bazuar në nenin 135, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 29, paragrafi 1, 2, 3 të Ligjit të Avokatit të Popullit, më lejoni të paraqes raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës.

Raportimi vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit para Kuvendit të Republikës së Kosovës është një mundësi e mirë për të reflektuar mbi ndikimin, që ky mekanizëm i pavarur ka në kontrollin e punës dhe shërbimeve të autoriteteve publike kundrejt qytetarit, lidhur me efektivitetin e shërbimeve dhe shfrytëzimin e mjeteve juridike, respektimin e procedurave administrative, përmirësimin e administratës dhe llogaridhënien.

Në korrik të vitit 2015 kanë hyrë në fuqi tri ligjet bazë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, siç është Ligji për Avokatin e Popullit, Ligji për mbrojtje nga diskriminimi dhe Ligji për barazi gjinore, që kanë fuqizuar mandatin dhe i kanë dhënë kompetenca shtesë Avokatit të Popullit.

Këto ligje parashohin afate më të shpejta kohore për shqyrtimin e rasteve, themelimin e mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës, mbulimin jo vetëm të sektorit publik, por edhe atij privat, përkritazi me rastet e diskriminimit, masa ndëshkimore për mosbashkëpunimin me Avokatin e Popullit, inicimin e procedurave gjyqësore nga Avokati i Popullit, paraqitjen e Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës apo me këskurje në proceset gjyqësore, që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe të mbrojtjes nga diskriminimi.

Duhet ritheksuar se Avokati i Popullit si kategori e veçantë dhe e pavarur kushtetuese, në thelb të mandatit dhe misionit ka mbikëqyrjen e mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike. Në përmbushje të këtij roli vizioni mbetet qartazi përkitazi me çështjet kryesore, me të cilat përqendrohet puna e Institucionit të Avokatit të Popullit e ajo është fuqizimi dhe zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe së këndejmi, rritja e besimit në këtë institucion. Së dyti, shtrirja e njohurive për rolin e institucionit të Avokatit të Popullit te secili individ, në gjithë vendin dhe dyert e hapura për t'i pranuar dhe trajtuar ankesat e tyre dhe së treti, bashkëpunimi i ngushtë me mediet, shoqërinë civile dhe institucionet publike në funksion të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, zbatimin e ligjshmërisë, transparencës dhe llogaridhënies.

Duke konsideruar raportin vjetor të Avokatit të Popullit drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës, si një rezyme të përgjithshme, për funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2015, duhet rikujtuar sidomos progresin në dy çështje kyçe: e para, në publikimin e raporteve për rastet e veçanta të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe këtë me një progres të 100%-të krahasuar me vitin 2014, ndërsa lidhur me zbatimin e rekomandimeve nga institucionet publike të Kosovës kemi një rritje prej 50% të zbatimit të rekomandimeve.

Ky progres në zbatimin e rekomandimeve konsideroj se ka qenë rezultat i inicimit nga ana e Avokatit të Popullit të një komunikimi intensiv me autoritetet publike, me qëllim të zgjedhjes pozitive të rasteve, në afate efektive kohore dhe në funksion të avancimit të përgjithshëm të të drejtave të njeriut. Ky rezultat pozitiv përkitazi me zbatueshmërinë e rekomandimeve është gjithashtu rezultat i angazhimit të përbashkët të stafit të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe rritjes së përgjegjshmërisë nga ana e autoriteteve publike, sa i përket përmbushjes së obligimeve kushtetuese dhe ligjore, në shërbim të qytetarit.

Gjithsesi, gjendja e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës imponon domosdoshmërinë e konsolidimit të sistemit ligjor, i cili vazhdon të jetë i fragmentuar dhe në shumë raste i paharmonizuar. Avokati i Popullit gjatë vitit 2015 ka përcjellë procesin e hartimit, shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve, me ç'rast ka vërejtur se prej 100 projektligjeve të parapara për shqyrtim dhe miratim gjatë vitit 2015, sipas programit legjislativ, shumica dërrmuese e tyre 65 prej projektligjeve janë me ndryshime dhe plotësime.

Ky fakt është indikator, që dëshmon se ligjet e miratuara nuk kanë përmbushur standardin e kualitetit të dëshiruar dhe se nuk kanë qenë në pajtim me zhvillimet në sektorë, të cilat kanë mëtuar t'i rregullojnë. Proceset e këtilla ligjore nuk ofrojnë qëndrueshmëri të sistemit juridik dhe gjithashtu kërcënojnë rëndë parimin e sigurisë juridike.

Zhvillimet e tjera në sistemin ligjor nuk ofrojnë mundësi për zbatim adekuat të ligjit, jo vetëm nga organet ekzekutive, por edhe në rastet e sanksionimit nga organet gjyqësore në procedurat përkatëse administrative, civile apo edhe kundërvajtjesh. Një problem tjetër, i cili e ka përcjellë procesin e hartimit të ligjeve është edhe mos unifikimi i terminologjisë juridike, prandaj është e nevojshme që sa më shpejtë të fillojë procesi i hartimit të fjalorit të terminologjisë juridike, i cili do të përdorej në procesin e miratimit të ligjeve dhe do të ndihmonte sponsorizuesit e ligjeve, që të vijnë nga degët e ndryshme të Qeverisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjithashtu ka dhënë opinion për nevojën e fillimit të dy proceseve paralele në Kuvendin e Kosovës, që gjithashtu kanë të bëjnë me fushën legislative. E para ka të bëjë me procesin e konsolidimit të legjislacionit në fuqi, përkatësisht procesin e harmonizimit të ligjeve, ndërsa e dyta ka të bëjë me procesin e kodifikimit të ligjeve, që nënkupton përmbledhjen e ligjeve, që rregullojnë fushën e njëjtë apo të përafërt. Kodifikimi i ligjeve do të sigurojë që gjithë legjislacioni i një fushe apo të një resori të jetë i përmbledhur në një dokument, me çka do të lehtësojë qasje në ligje, që përbën kusht themelor për zbatimin, por edhe do të ndihmonte zbatimin e Ligjit për kontroll efektiv në fushat përkatëse të së drejtës.

Sistemi gjyqësor gjatë vitit 2015 ka vazhduar të përballet me mbingarkesë të lëndëve dhe, në këtë mënyrë, nuk ka pasur mundësi për të siguruar një mekanizëm efektiv juridik për mbrojtjen e të drejtave.

Gjatë këtij viti raportues Avokati i Popullit ka pranuar 587 ankesa kundër gjykatave, prej të cilave 249 janë hetuar për shkelje të pretenduara të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Në praktikë, ky numër mund të jetë edhe më i madh dhe paraqet sfidë për autoritete e Kosovës në përgjithësi dhe mund të ketë implikime të mëdha financiare, në rast të anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, me ç'rast qytetarëve të Kosovës do t'u hapen rrugët për të kërkuar të drejtat e tyre edhe në Gjykatën Evropiane për të drejtat e njeriut.

Administrata Publike në të dyja nivelet, qendrore dhe lokale, vazhdon të jetë jo llogaridhënëse dhe në pjesën më të madhe për shkak të mungesës së kontrollit adekuat gjyqësor të sektorit të administratës.

Numri më i madh i rasteve të hetuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë periudhës raportuese kanë të bëjnë me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtjen e pronës, të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, si dhe të drejtën për mjete juridike.

Në numrin më të madh të rasteve autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit, rreth 75% janë gjykatat, ministrinë dhe komunat. Avokati i Popullit ka dy aspirata themelore për punën: e para për të rivendosur të drejtën e shkelur të individëve, të cilët kanë përjetuar shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut; dhe e dyta, për të përmirësuar punën e administratës dhe autoriteteve publike, përgjegjëse për shkelje të shkaktuara.

Në këtë kontekst, Avokati i Popullit do të jetë institucion përmes të të cilit do të mund të adresohen dhe jepen zgjidhjet për shqetësimet dhe ankesat e qytetarëve kundrejt veprimeve apo mosveprimeve të autoriteteve publike. Në të njëjtën kohë Avokati i Popullit do të jetë vlerësues dhe promovues i praktikave të mira dhe pozitive, me qëllim të konsolidimit të vlerave demokratike, të cilat në bazamentin e vet kanë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutën e vendit, ashtu siç është edhe marrëveshja dhe instrumentet ndërkombëtare të zbatuara drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

Të drejtat e njeriut kanë qenë parim udhërrëfyes dhe çështje qendrore e ndryshimeve në këtë vend, prandaj çdo udhëheqës institucional dhe zyrtar publik duhet të respektojë dhe përkrahë të

drejtat dhe liritë e njeriut dhe mandatin e Avokatit të Popullit, me qëllim të zgjidhjes së problemeve të qytetarit në njëërën anë dhe forcimin e demokracisë dhe fuqizimin e sundimit të ligjit.

Liritë dhe të drejtat e njeriut, jo vetëm garanci abstrakte kushtetuese, nuk duhet të jenë garanci abstrakte kushtetuese, ato në esencë janë mjete përmes të cilave duhet të krijojmë mënyrën tonë të jetesës dhe shpresën për të ardhmen. Faleminderit! Shpreh gatishmërinë time për t'u përgjigjur në çdo pyetje që mund të keni lidhur me raportin vjetor të vitit 2015 së Institucionit të Avokatit të Popullit.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani fjala është juaja. Fjalën e ka kryetarja e Komisionit Funkcional, po qe se është këtu! Apo dikush tjetër në emër të saj. Zonja Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione duke u bazuar në nenin 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2016 shqyrtoi raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015 dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

Rekomandim:

Kuvendi ta miratojë raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015.

Arsyetim:

Institucioni i Avokatit të Popullit duke u bazuar në nenin 29.1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, i ka paraqitur Kuvendit të Republikës së Kosovës raportin për vitin 2015.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015 në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2016. Raporti për nga ana përmbajtjesore, metodologjia e hartimit dhe strukturimi është gjithëpërfshirës si dhe plotëson kushtet për t'u proceduar në Kuvend për miratim.

Mbi këtë bazë komisioni vendosi që Kuvendit t'i rekomandojë miratimin e raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Institucioni i Avokatit të Popullit ka sjellë raportin sipas standardeve të parapara dhe konsideroj që është njëri prej raporteve më të mira, që është dorëzuar nga ky institucion, deri më tani. Dhe, ajo që vlen të theksohet, është që buxheti i tyre, i cili ka qenë i planifikuar në fillim 1 091 332,99 centë është reviduar me vendim të Qeverisë dhe ka qenë 979 285 euro, ndërsa pas përfundimit,

domethënë në përfundim, pasi që janë bërë shkurtime, ky institucion ka pasur vetëm 932 147 euro, që kanë shpenzuar në një përqindje prej 94,66% nga shuma që kishin në fond 382 373 euro.

Ajo që vlen të theksohet, se ky institucion, që shpresoj se gjatë hartimit të Buxhetit për vitin vijues, duhet të ketë pavarësinë e plotë në hartimin e Buxhetit. Unë konsideroj që duhet t'i mundësohet këtij institucioni që të bëjnë vetë buxhetin dhe ta sjellin në Parlament për aprovim, ashtu siç do ta propozojnë vetë, pavarësisht kësaj që do të jetë një temë që do të diskutohet dhe që do të mundohemi që kjo të jetë kështu, për arsye se kjo ka qenë edhe një standard që është kërkuar nga institucionet ndërkombëtare për këtë institucion.

Shpenzimet e tyre kanë qenë mjaft efektive, sepse kanë shpenzuar në paga dhe mëditje 100%, mallra dhe shërbime 85,56% dhe në shpenzime komunale 27,83%. Këta nuk kanë pasur investime kapitale, problemet e tyre të ditura kanë qenë lidhur me hapësirën, që konsideroj se ajo është zgjedhur në momentet e caktuara dhe që këta mund të akomodohen aty, mirëpo atë që vlen të theksohet se këtij institucioni duhet t'i krijohet një buxhet më i madh dhe një pavarësi më e madhe buxhetore.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa rekomandojmë, që raporti financiar i Institucionit të Auditorit të Popullit të aprovohet.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Topalli e ka fjalën.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Avokat i Popullit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe ka vlerësuar, se ky raport është punuar me një metodologji profesionale dhe ka pasqyruar punën e këtij institucioni shumë të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.

Duke ditur se tek institucionet e Avokatit të Popullit mund të adresohen dhe të gjejnë zgjidhje shqetësime dhe ankesat e qytetarëve, vlen të përmendet rekomandimi nr. 201/2015. Çështja e rastit të ngritur nga zoti Bajram Krasniqi, anëtar i Komisionit të Familjeve të Dëshmorëve të Kombit, kundër Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorëve të Kombit, Invalidë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo të internuarit e Ushtrisë Çlirimtare, për shkak të mosnjohjes së statusit të dëshmorëve të rënë brenda periudhës 1968 – 1999. Nga kjo kuptojmë, se Komisioni Qeveritar ka refuzuar kërkesat e familjarëve të dëshmorëve të kombit të rënë brenda periudhës 1968 – 1999. Sipas ankuesit arsyet e refuzimit ishin, se Komisioni Qeveritar kishte deklaruar se nuk është kompetent për të vendosur lidhur me kategorinë e kombit të rënë gjatë kësaj periudhe.

Lidhur me këtë Avokati i Popullit ka rekomanduar, që Qeveria e Republikës së Kosovës t'i jep mandat Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorëve të kombit,

invalidë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo të internuarit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ose të themelojë një komision të ri, i cili do të shqyrtonte kërkesat për njohje të statusit të dëshmorëve të kombit, të rënë në periudha të ndryshme historike, sipas përcaktimit të vetë ligjit.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me përkrahjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarrë iniciativë për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në mënyrë që përkufizimet e ligjit të jenë në harmoni me përmbajtjen e ligjit. Andaj, kjo e drejtë legjitime e kërkuar nga familjarët e dëshmorëve të kombit, si dhe nga zoti avokat, të rënë në periudha... domethënë, nga familjarët e dëshmorëve të kombit të rënë në periudha duhet të marrë përgjigje nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Para nesh Avokati i Popullit paraqiti progresin në zbatimin e rekomandimeve dhe atë në 50% të zbatimit të rekomandimeve. Ky progres ka pasur si rezultat zgjidhjen pozitive të rasteve në afatet efektive kohore dhe krejt në funksion të avancimit të përgjithshëm të të drejtave të njeriut. Këto rezultate pozitive në zbatueshmërinë e rekomandimeve janë rezultat i angazhimit të përbashkët të stafit të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe rritjes së përgjegjësisë nga ana e autoriteteve publike, sa i përket përmbushjes së obligimeve kushtetuese dhe ligjore në shërbim të qytetarit.

Andaj, në fund, ftoj deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, që të votojnë raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

ISMET BEQIRI: Faleminderit zoti nënkryetar!

Edhe unë i bashkëngjitem vlerësimit të parafolësve - kolegëve të mi deputetë, varësisht nga funksioni që u paraqitën si kryetar komisioni apo edhe emër të grupeve për të thënë qëndrimin edhe të grupit parlamentar edhe vlerësimit se është një avancim i dukshëm në pasqyrimin e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit dhe për këtë e meriton një përgëzim të veçantë zoti Jashari.

Mund të thuhet lirisht se është një raport mjaft përmbajtjesor, informues, konciz, i qartë dhe pasqyron saktë të gjithë aktivitetin, sfidat nëpër të cilat ka kaluar si institucion sepse që të gjithë e dimë se vërtet kishim edhe telashe deri sa u zgjodh edhe Avokati pas shumë orvatjeve dhe përpjekjeve tona, gjë që të gjitha këto sigurisht mund të ndikojnë edhe në grumbullimin e punëve dhe problemeve të caktuara, duke pasur parasysh po ashtu edhe kushtet edhe rrethanat në të cilat, duke e përfshirë hapësirën, është punuar.

Për të mos zgjatë, sepse është vlerësim edhe i Komisionit përkatës, ne si Grup Parlamentar e inkurajojmë Avokatin e Popullit e të gjithë stafin e tij dhe Institucionin që edhe në të ardhmen të ketë një aktivitet të tillë jashtëzakonisht intensiv dhe padyshim se e ka përkrahjen tonë, për aq sa janë kompetencat tona, duke pasur qartë faktin se është institucion i pavarur, por që normalisht edhe ne si institucion ligjvënës kemi obligime të caktuara, duke e përfshirë edhe buxhetin sepse është e qartë që pavarësia financiare ndihmon shumë edhe në pavarësinë në një mënyrë të një institucioni të caktuar, në këtë rast Avokatit të Popullit.

Pra, ne si Grup Parlamentar e përkrahim dhe do ta votojmë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rashiq e ka fjalën!

NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsjedavajući!

Ja sam takođe deo Komisije koji inenzivno sarađuje sa gospodinom Jašarijem i ja oko izveštaja samog i detalja odnosno svaki naš sastanak je bio vrlo obiman i detaljan pogotovo u aktivnostima koji radi Narodni advokat i njihova kancelarije. I meni se, naravno oko samog izveštaja namam nikakve dopune jer faktički smo i mi na neki način bili ti koji su možda dodali ponešto unutar tog izveštaja ili su nešto naglasili u samom izveštaju.

Ali ono što bih ja želeo da kažem, jeste da kada je gospodin Jašari pričao o tome, o eventualnim žalbama ili zahtevima različitih stranaka da se obrati pažnja ili tražili intervenciju Narodnog advokata u vezi suđenja koje su potencijalno mogle da budu ne fer ili mogla na bilo koji način da ugroze neku proceduri ili da ugroze nečije prava, pa ima i jedan slučaj baš koji se tiče vaše kancelarije odnosno tiče se zamenika narodnog advokata i taj slučaj je zadnjih tri godine na stendbay ili na čekanju. Naime, vaš prethodnik bivši narodni advokat je iz razloga koji ja pravno nisam video osnovu, je u daljoj ili je isterao zamenika Narodnog advokata i od tad postoji jedan slučaj koji se nalazi na sudu i znajući našu dobru sudsku ekspeditivnost nažalost on se tamo nalazi već tri godine.

I ja bih u ime Grupe koju predstavljam zamolio vas da možda jedno suđenje koje bi stvarno trebao da ispratite i da to bude obavljeno onako na vrlo prostom nivou, je baš upravo suđenje koji se tiče direktno vaše kancelarije, odnosno tiče se zamnika narodnog advokata koji je bio srpske nacionalnosti.

Ja lično, iako cenim vaš rad, smatram da bi predstavnik odnosno Narodni advokat trebao da bude iz nevećinske zajednice, jer mislim da je to uvek na svakom društvu najslabija karika i verovatno i zajednica koje nisu većina. A kako je ono stara izreka, kaže društvo je jako ili organizovano samo ukoliko je najslabija karika jaka.

Ali bez obzira na to, bez obzira na moje mišljenje, ko bi trebalo da bude narodni advokat, mislim da je minimum pravnog i iskrenog zadovoljenja da zamenik Narodnog advokata bude iz redova nevećinskih zajednica.

E, u ovom slučaju, i pričajući o zameniku Narodnog advokata, smatram da postoji prostora za intervenciju odnosno, nazovem i to, da nekako, na bolju analizu slučaja koja se dešava sa zamenikom Narodnog advokata. Mi smo to i na komisiji pričali, inače se i komisija bavi izaberom Narodnog advokata, odnosno njegovog zamenika, ali u ovom slučaju su i nama ruke vezane jer je slučaj i dalje na sudu. Tako da, jedna molba za vas, mislim da mi to shvatite kao jedan dobar profesionalac i veliki institucionalista, da je vrlo bitno da taj slučaj reši kako bi mogli i imali autoriteta da bilo koje druge slučajeve rešavate u korist građana, bilo da su u pitanju pojedinci ili određene grupacije, ili institucije.

Tako da ja želim da nastavimo sa radom koji smo i do sada imali, koji je bio vrlo dobar i naravno ohrabrujem vas da i u buduće budete tako iscrpni i tako veliki detaljista što se tiče vašeg rada i

onoga što je vaša kancelarija sprovela, bilo da se radi o godišnjem izveštaju ili o šest meseci. Hvala puno!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kujtim Paçaku e ka fjalën.

KUJTIM PAÇAKU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Edhe unë si pjesë e komisionit për të drejtat e njeriut, pjesë përbërëse e Komisionit kemi fjalë miradie për punën dhe për raportin e arritur në komision për vitin 2015.

Por jo vetëm Komisioni, edhe ne të pjesëtarëve të Grupit Parlamentar “6+” me seriozitet e kemi hartuar raportin dhe kemi biseduar për çështje shumë prioritare për komunitetin dhe kemi ardhur në përfundim se ky raport krijon nivel të lartë të besueshmërisë në punë, ka rezultate të efikasitetit dhe publikimi i rezultateve të arritura gëzojnë faktin se edhe pjesëtarët e komuniteteve pakicë tanimë kanë më të qartë punën në krahasim me punët e mëparshme.

Gjë tjetër, e cila nuk u përmend është se ekziston edhe komisioni i pavarur i mediave i cili lavdëron punën e Avokatit dhe se me seriozitet do të merret me tepër me problemet e të drejtave të njeriut të gjitha komuniteteve (komisioneve), atëherë në emër të Grupit “6+” unë uroj punën e zotëri Jasharit të cilën e bëri por jo vetëm të zotëri Jasharit sepse ai e ka një ekip cilësor me bashkëpunëtorë të shkëlqyeshëm, andaj ftoj deputetët që ta miratojnë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Salihe Mustafa e ka fjalën!

SALIHE MUSTAFA: I nderuar kryesues,

Ministër,

Avokati Popullit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Konsideroj se raporti i Institucionit të Avokatit të Popullit është një raport me përmbajtje të mirë ku trajtohen çështje të ndryshme si nga aspekti i legjislacionit, gjyqësorit, ekzekutivit e gjithashtu edhe problemet e natyrave tjera si pronësia, barazia gjinore, të drejtat e fëmijëve, çështjet e mekanizmit për mbrojtje nga torturat e tjera.

Është raport i strukturuar mirë dhe me rekomandime konkrete për institucionet përkatëse.

Edhe pse zbatimi i rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit është në rritje, institucionet kanë ende shumë punë për të bërë, sepse rekomandimet duhet të zbatohen plotësisht.

Të nderuar kolegë,

Për mua është shqetësues çështja e rivlerësimit të personave me aftësi të kufizuara për pensionet e tyre, ku në raport potencohet se edhe përkundër faktit që personi me aftësi të kufizuara, me diagnozë të njëjtë dhe gjendje shëndetësore të pandryshuar, pas rivlerësimit nga ana e komisionit mjekësor largohet nga lista e përfituesve të pensioneve sepse, sipas vlerësimit të komisionit, ata nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara.

Kjo vë në pyetje korrektësinë e punës së komisionit mjekësor, andaj e mbështes këtë rekomandim dhe kërkoj nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale zbatimin e këtij rekomandimi në afat sa më të shkurtër.

Një brengë dhe një rekomandim tjetër me rëndësi të veçantë të Institucionit të Avokatit të Popullit është se lëvizja e lirë dhe e papenguar e personave me aftësi të kufizuara vazhdon të mbetet problem edhe nëpër hapësira publike dhe institucione publike, duke përfshirë edhe shërbimin spitalor klinik universitar të Kosovës.

Shpeshherë ndodhë që këtyre personave t'u jepet ndihma mjekësore në vende joadekuate, në pamundësi që të kenë qasje në vende ku duhet të trajtohen.

Edhe ky shqetësim dhe rekomandim i Avokatit të Popullit duhet të implementohet me urgjencë, edhe pse ne e dimë që personat që lëvizin me karrocë kanë shumë qasje edhe në institucionet tjera, por nuk tolerohet që të mos kenë mundësi të marrin trajtim shëndetësor adekuat.

Të nderuar kolegë,

Edhe përkundër raportit të mirë dhe rekomandimeve konkrete të dhëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit për institucionet përgjegjëse, mbetet shumë punë për të bërë edhe nga vetë Institucioni i Avokatit të Popullit.

Kur e them këtë, kam parasysh faktin se numri i përgjithshëm i ankesave drejtuar këtij institucioni për vitin 2015 ka qenë 1 995 ankesa.

Numri i ankesave të shpallura të papranueshme nga Institucioni i Avokatit të Popullit është 1 262 ankesa, që domethënë se nga 1 995 ankesa të qytetarëve, vetëm 733 prej tyre kanë qenë ankesa të pranueshme.

Kjo e dhënë tregon për nevojën e madhe për planifikim të fushatave sensibilizuese nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit në mënyrë që qytetarët të njoftohen për rolin dhe kompetencat e këtij institucioni.

Për një punë edhe më efikase në këtë institucion, është e nevojshme që Institucioni i Avokatit të Popullit të fillojë procedurat për zgjedhjen e zëvendësve të tij pasi që ka kohë që zëvendësit e Institucionit të Avokatit të Popullit u është skaduar mandati.

Unë e përkrah raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe do ta votoj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ne në çdo vit miratojmë raportin e Avokatit të Popullit dhe japim komplimente për disenjimin, për metodologjinë se si... por nuk e adresojmë si Parlament problemin e raportimit të Avokatit të Popullit kujt t'i adresohet. Dhe, nëse ne fillojmë të miratojmë raportet konkluduese të shkeljeve të drejtave të njeriut, të mosrespektimit të ligjit nga institucionet, nga nxjerrja prej punës prej shefave të punonjësve në mënyrë për interesa personale ose interesa të ndryshme në vendimet gjyqësore të tilla, unë mendoj që Parlamenti i Kosovës mbi bazën e këtij raporti të ngritin

komisionet e posaçme dhe të takohen me Komisionin qoftë atë për legjislacion, qoftë Komisionin për të Drejtat e Njeriut, të mbrojtjes së drejtave në punë, të fëmijëve dhe trajtimit mjekësor të barabartë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, ne do të mbesim duke miratuar raporte pa efekte.

Unë nga Avokati i Popullit kisha pasur qejf të di, nga vërejtjet e tyre, statistikisht sa efekte kanë qenë që janë konkluduar në shkelje juridike që janë bërë në nxjerrjen e punonjësve, që po shohim nëpër media, nga puna, qoftë nga sektori privat, qoftë nga sektori publik, e në sektorin publik është më i shprehur ndërsa në sektorin privat është i pa trajtuar.

Ne pamë 200 punëtorë, për shembull, që janë dalë nga KEDS-i prej pune dhe i shohim dhe i shohim nëpër media, ata thonë kemi të drejtë, këta thonë s'keni të drejtë, ky thotë kontratën kolektive e ka respektuar apo s'e ka respektuar, prandaj mbi këto konkludime praktike ne duhet të shohim apo kemi sukses që ta arsyetojmë ekzistencën e Avokatit të Popullit dhe sa po respektohet Avokati i Popullit.

Dhe unë mendoj që Avokati i Popullit është duke u respektuar vetëm si dekor në një pjesë të strukturës ligjore dhe të obligimeve që neve na rrjedhin nga Bashkimi Evropian për me pas këtë si institucion, por, nuk po i implementojmë vërejtjet e tyre në institucione.

Sot fillojnë brenda Qeverisë së Republikës së Kosovës ministrat dhe zëvendësministrat kritikohen për nxjerrjen nga puna pa bazë dhe ne, e di edhe Avokati i Popullit, që dikush është duke e shkelur, o punëdhënësi o punëmarrësi. Prandaj ne nuk e kemi atë fidbekun e rezultateve, dhe mbi bazën e këtyre ne duhet t'i shohim realisht gjërat, a është duke prodhuar efekte Avokati i Popullit apo është duke u marrë vetëm si kor i vajtimit. Nëse është si kor i vajtimit dhe po vajton situatën, atëherë ne po themi - për Bashkimin Evropian po e mbajmë Avokatin e Popullit se po e kërkon si standard, mirëpo nuk kanë efekte implementuese vërejtjet e tij. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Rexhepi e ka fjalën.

EMILJA REDŽEPI: Zahvaljujem se gospodine predsedavajući!

Gospodine Jašari, vi kao Narodni advokat, naše se oči uprte u vas i u instituciju koju vi zastupate i molim vas da u buduće poštujuete zakon o zaposlenosti manjinskih zajednica i apelujte molim vas na vašu administraciju da ima što većeg broja zaposlenosti pripadnika manjinskih zajednica. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Veton Berisha, i fundit!

VETON BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Për të mos e përsëritur kolegun, zotin Muja për pjesën më të madhe që unë pajtohem, e ne na duhet tani të mos jemi vetëm dëgjues të këtij raporti, por cilat janë veprimet apo hapat më tutje. Unë ndiej obligim moral që të falënderoj dhe të përshëndes raportin e Avokatit të Popullit dhe të falënderoj për hapjen e këtij institucioni ndaj kërkesave të komunitetit egjiptian, të cilat vërtet kanë qenë të deponuara me vite, ndërsa pas ardhjes së zotit Jashari në këtë pozicion komuniteti egjiptian ka filluar të adresojë më tepër kërkesa të cilat pa humbur kohë janë trajtuar.

Ky është një prej institucioneve vërtet më të besueshme dhe vetë fakti i daljes së raporteve të cilat janë publike dhe të pa imponuara, do të thotë del raporti ashtu siç është gjendja, ne vërtet na bën të fillojmë të besojmë në këtë institucion për çështjet me të cilat zoti Jashari dhe përfaqësuesit e tij janë marrë dhe adresuar vërtet ka qenë jashtëzakonisht i mirëpritur nga komuniteti egjiptian e në veçanti më duhet të theksoj për çështjen e lagjes Kristal në Pejë, kur reagimi i menjëhershëm i Avokatit të Popullit ka filluar që ai vendbanim të jetësohet dhe të jetë i banueshëm.

Do të thotë, vetë rëndësia e Institucionit dhe vetë fakti i dorës së këtij institucioni në komunitet e ka një efekt jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe mendoj që ne duhet të vazhdojmë ta kemi këtë besim dhe patjetër duhet ta votojmë këtë raport, por natyrisht se nuk duhet të presim dhe të kërkojmë edhe pse nuk mund të kënaqemi vetëm me këto raporte, sepse jeni fillim të mandatit dhe mendoj që deri në fund të mandatit tuaj ka shumë për të bërë dhe ju ftoj që vazhdimisht të vazhdoni me këtë intensitet.

Edhe një herë, ju ftoj ta votojmë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Jashari, a doni të shtoni diçka? Atëherë, urdhëroni, fjalën e keni ju.

HILMI JASHARI: Faleminderit, zoti kryesues!

Lidhur me komentin e zotit Muja, unë do ta njoftoj se pajtohem plotësisht me vërejtjet tuaja. Është një prej shqetësimeve dhe brengave tona gjithashtu sepse vetë filozofia e krijimit të Institucionit të Popullit qëndron mu në faktin që ky institucion do të duhej të njoftonte përfaqësuesit e popullit mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në mënyrë që përfaqësuesit e popullit pastaj të ushtrojnë kontrollin, të jenë në gjendje të marrin vendime, qëndrime, konkludime ose të nxjerrin konkluzione për shkelje të drejtave të njeriut sepse vetëm në këtë mënyrë arrihet efekti i plotë i punës që bën Institucioni i Avokatit të Popullit.

Unë për veten time, mendoj personalisht, se dorëzimi i raportit vjetor dhe një proces formal i votimit, nuk e ndihmon sepse krejt ideja është që Avokati i Popullit, por edhe institucionet tjera të pavarura, të njoftojnë përfaqësuesit e popullit mbi shkeljet që kanë shkaktuar administrata ose institucionet tjera publike. Në këtë formë mund të merren qëndrimet dhe mund të përmirësohet politika.

Ne sigurisht brenda këtij viti do t'ia dorëzojmë një rekomandim të tillë Kuvendit të Kosovës me të cilin do të kërkojmë që jo vetëm Institucioni i Avokatit të Popullit mirëpo edhe të gjitha institucionet tjera të pavarura që nën kapitullin XII të Kushtetutës së Kosovë të përcillet e njëjta praktikë. Ata të dorëzojnë raportet mirëpo t'i jepet mundësi përfaqësuesve të popullit të debatojnë nëse është nevoja gjatë gjithë ditës, mirëpo në fund do të duhej të merren qëndrime lidhur me atë se çka duhet përmirësuar dhe çka duhet të vendosim mirëpo kjo është e tërë ideja filozofike, e di që është pengesë Rregullorja e Kuvendit, e ne mund të propozojmë ndryshimin e kësaj rregulloreje dhe të harmonizohet me pritjet që i kemi edhe në institucionet të pavarura, por është edhe në interesin e përfaqësuesve të popullit dhe unë besoj kështu që, nëse janë institucionet e pavarura me një anë dhe Kuvendi në anën tjetër të lidhura atëherë interesi përfundimtar është sigurisht i qytetarit dhe është qytetari ai që përfiton dhe është mënyra më e

mirë e mundshme. Kjo është praktikë edhe e shteteve tjera, ombudsmanët e bëjnë po të njëjtën punë, debatohet gjatë gjithë ditës mbi rekomandimet dhe në fund merren qëndrime dhe eventualisht administrata ose qeveria udhëzohen se si të veprojnë.

Sa për njoftim, ne i kemi dërguar një rekomandim kryeministrit të Kosovës gjithashtu dhe kemi kërkuar që përveç Avokatit të Popullit edhe kryeministri i Kosovës, si kreu i Qeverisë, të raportojë bile së paku një herë në vit para përfaqësuesve të popullit lidhur me atë se çfarë ka bërë ai si kryeministër lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Ky rekomandim është miratuar tani nga kryeministri dhe javën e kaluar ka hyrë në fuqi, është nënshkruar dhe tani çdo muajin e dytë Qeveria e Kosovës do ta ketë në agjendën e vet të rregullt pikën lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit mirëpo gjithashtu edhe të shoqërisë civile ose rekomandimeve që mund të dalin dhe besoj se është një mekanizëm i përshtatshëm që mund të ndihmojë përfaqësuesit e popullit për të krijuar idenë dhe për të qenë në gjendje për të marrë qëndrime e vendime për përmirësimin e saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e raportit vjetor të punës së Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015.

Në sallë janë 71 deputetë. Votojmë tani!

Faleminderit! Janë 65 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim dhe miratohet.

Zoti Jashari jeni i lirë, faleminderit për raportin!

9. Shqyrtimi i raportit të punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2015

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar raportin vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Selviqe Halimi për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion, konform Rregullores së punës të Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me 10 maj 2016 shqyrtoi raportin e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe i paraqiti Kuvendit rekomandimin që të miratohet raporti i punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2015. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Osmani e ka fjalën!

NASER OSMANI: Po ashtu, Instituti Gjyqësor i Kosovës e ka dorëzuar raportin vjetor financiar për vitin 2015 dhe sipas të dhënave të kërkuara raporti pasqyron të gjitha ato të dhëna të cilat kanë qenë të parapara në buxhet. Ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit si dhe të dhënat për shpenzime të buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike, si dhe është bërë krahasimi me vitin paraprak.

Buxheti fillestar i ndarë për Institutin gjyqësor të Kosovës për vitin 2015 ka qenë 602 628 euro, ndërkaq buxheti me rishikim ka qenë 556 994 euro. Buxheti përfundimtar i Institucionit ka qenë 513 718 euro.

Duke i përfshirë ndryshimet që kanë ndodhur me rishikimin e buxhetit dhe shkurtimet sipas vendimit të Qeverisë, nga gjithsej kjo shumë e mbetur, do të thotë, janë harxhuar 95,75% të buxhetit ose 491 964 euro.

Kryesisht kategoria e pagave ka qenë e mbuluar 100%. Shpenzimet komunale po ashtu 100%. Mallra dhe shërbime 93,03%, ndërsa investimet kapitale nuk ka pasur fare.

Prandaj, duke pasur parasysh që raporti ka përmbajtur të gjitha standardet e raportimit, sipas Ligjit mbi menaxhimin e financave publike, Komisioni i rekomandon seancës që ta votojë raportin financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2015. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Agim Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

AGIM ALIU: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar ministër zoti Murati,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2015 dhe e konsideron se është një raport që duhet miratuar, sepse është punuar mirë dhe i plotëson standardet e përgatitjes së një raporti.

Raporti duhet miratuar edhe për faktin se Instituti Gjyqësor i Kosovës ka bërë një punë të mirë brenda mandatit dhe përgjegjësi që i ka pasur, përkundër vështirësive të paraqitura në punën e tij të bërë gjatë këtij viti.

Instituti Gjyqësor i Kosovës si institucion i pavarur dhe kryesor për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe përgatitjen profesionale të tyre për sistemin e drejtësisë këtë vit ka përfunduar trajnimin fillestar të gjeneratës së pestë të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë për gjithsej 28 kandidatë që i janë nënshtruar provimit përfundimtar.

Është kjo një punë për t'u vlerësuar, siç është edhe ai i trajnimit të vazhdueshëm për gjyqtarë e prokurorë dhe stafit mbështetës të gjykatave të gjitha lëmive të së drejtës, përfshirë atë penale, civile dhe atë të drejtësisë për fëmijë, që përfshijnë 115 gjyqtarë dhe prokurorë për këtë vit.

Instituti Gjyqësor i Kosovës si dhe disa institucione dhe agjenci të tjera të pavarura, që i raportojnë Kuvendit, vazhdojnë të mbeten për një kohë të gjatë pa drejtor të zgjedhur dhe vazhdojnë të bëjnë punën e tyre me ushtrues detyre, prandaj konsideroj se duhet përmbyllur një praktikë të tillë e udhëheqjes së këtyre institucioneve dhe në këtë rast edhe Institutit Gjyqësor të Kosovës në mënyrë që puna e këtyre institucioneve të jetë edhe më e suksesshme.

Gjatë punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës, janë paraqitur vështirësi e sfida edhe për faktin se gjatë punës së këtij legjislacioni është ndryshuar Ligji për gjykatat, Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe kjo ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në punën e Institutit Gjyqësor të Kosovës sepse ka ndërhyrë në punën e tij, prandaj edhe duhet një konsolidim ligjor së bashku me Ministrinë e Drejtësisë.

Një ndër sfidat e Institutit Gjyqësor të Kosovës mbetet numri jo i mjaftueshëm i stafit profesional dhe çështja e trajnuesve, a ka vlerësime për ta dhe cila është cilësia e tyre në punën dhe angazhimin që e bëjnë.

Një vështirësi shtesë në punën e këtij institucioni është paraqitur edhe mungesa e ndërtesës për të si dhe pasurimi i bibliotekës ligjore në mënyrë të veçantë me tituj nga gjuha shqipe që janë të munguar në këtë bibliotekë.

Konsideroj se ecja e Institutit Gjyqësor të Kosovës nga themelimi i saj prej OSBE-së - Misioni në Kosovë në vitin 2000 që edhe e ka menaxhuar dhe financuar deri në vitin 2006 kur Kuvendi i Republikës së Kosovës me ligj e themelon si organ të pavarur e deri më sot, ka kaluar me sfida dhe vështirësi të ndryshme në mandatin dhe përgjegjësitë që ka pasur në mënyrë që të ketë sa më shumë profesionistë dhe profesionalizëm në institucionet e drejtësisë, por besojmë se me projektligjin për Akademinë e drejtësisë që e kemi kaluar në Kuvend do të bëhet transformimi i Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe se përfundimisht kjo akademi e drejtësisë do të jetë në nivele të larta të përgjegjësisë sipas obligimeve dhe përgjegjësi që i përcakton ligji në mënyrë që të përmbushë misionin që do t'i jepet.

Duke vlerësuar edhe një herë punën e Institutit Gjyqësor të Kosovës, përkundër këtyre vështirësive dhe sfidave, por edhe duke besuar në një transformim të shpejtë dhe të suksesshëm të saj në Akademi të Drejtësisë, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së kërkoj që deputetët e këtij Kuvendi të miratojnë raportin vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës me rekomandimet e paraqitura. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Agim Ademaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2015 dhe mendojmë se është një raport i punuar mirë.

Kryesisht Instituti Gjyqësor merret me trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe ndryshimi i pakos ligjore të gjyqësorit ka ndikuar në vështirësimin e punës së këtij instituti por mendojmë se me kalimin e kohës kjo do të rregullohet në mes Institutit dhe organeve tjera kompetente gjyqësore.

Shifrat që janë paraqitur në raportin e punës së këtij instituti janë mjaft të sakta e koncize dhe sa është kryer në mënyrë profesionale trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve kjo mbetet të shihet.

Dhe sido që të jetë, Grupi Parlamentar i LDK-së do të votojë pro këtij raporti të punës së këtij instituti dhe ftoj të gjithë kolegët që të votojnë pro. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Para se të futemi në votim, desha të them se edhe përkundër dëshirës së disave që të mos funksionojë Parlamenti, sot po shihet se mund të funksionojë mirë dhe uroj që kështu do të funksionojmë prapë edhe si koalicion edhe si përfaqësues të interesave të vendit.

I kemi të pranishëm 69 deputetë. Tani e vë në votim raportin. Votojmë tash!

Faleminderit!

Janë 63 vota për, 1 kundër dhe 4 abstenime dhe konstatoj se Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Institutit gjyqësor të Kosovës për vitin 2015.

Ju njoftoj se më 1 qershor do të ketë seancë për Ditën e Fëmijëve dhe ardhja është vullnetare. Ftesa e kryetarit është për të gjithë. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*